







FILLIMI I RRUGËS SË DREJTË

Tiranë, 2015



Titulli: **Fillimi i rrugës së drejtë**

Autori: Shoqata e njohurive islame

E përkthyen nga gjuha angleze: Bledar **SHEHU**
(mësimi 1-9), Liseda **RAMAJ** (mësimi 10-12)

E redaktoi: Hajri **SHEHU**

Recensent: Vullnet **MERJA**

E korrektoi: Vjollca **KARAJ**

Përkujdesja grafike: Sabrie **FEZA**

Kapaku: Sabrie **FEZA**

Botoi: Shoqata "**FLLADI**"



Parathënie

ME EMRIN E ALLAHUT, TË GJITHËMËSHIRSHMIT, MËSHIRËPLOTIT

Mëshira dhe paqja e Allahut qofshin mbi njeriun dhe të Dërguarin më të nderuar, Profetin Muhamed Bin Abdullah dhe pasardhësit e tij!

Të shkruash një tekst të thelluar për të formuar besimtarin, është fillimi i rrugës dhe ka shumë vështirësi, që kanë të bëjnë me përparësinë e formës dhe të përmbajtjes. Në këtë kontekst, në këtë libër janë bërë përpjekje për të qëndruar sa më shumë që të jetë e mundur larg argumenteve logjike dhe teologjike dhe për të përdorur drejtpërdrejt gjuhën e ndërgjegjes dhe të ndjenjës, në mënyrë që të zgjohet dhe të gjallërohet natyra e njeriut.



Në këto kohë interesash materiale, ne kemi shumë nevojë të shpresojmë se Allahu do të na japë sukses.

Libri është hartuar, me lejen e Allahut nga studiuesit e "Knowledge Center for Islamic Studies and Researches" (Qendra e dijes për studime dhe për kërkime islame), filial i "Islamic Cultural Knowledge Organization" (Organizata për dije dhe për kulturë islame).

**Islamic Cultural Knowledge Organization
Knowledge Center for Islamic Studies and Researches**



Mësimi një

NË KËRKIM TË SË VËRTETËS

Cilat janë pyetjet e para për një njeri?

A është jeta qëllim?

Cila është rruga e shpëtimit?

Hyrje

Kur lind njeriu, fillon udhëtimin e jetës së tij, që do të zgjasë për shumë vjet. Gjatë jetës ai do të përballet me një të ardhme të panjohur e gjithë shqetësime, të mbushur me shpresa dhe dhembje. Megjithatë, njeriu lundron në një oqean pyetjesh, që kërkojnë përgjigje me zë të lartë: Unë kam nevojë për të vërtetën. Unë nuk mund të pajtohem me padijen... Unë nuk do të ndihem i sigurt po të mos i di



përgjigjet e këtyre pyetjeve: Kush jam unë? Kush më ka sjellë mua këtu? Përse ekzistoj unë? Kur njeriu bën këto pyetje, ai zbulon se nuk i pëlqen të jetojë në errësirë; atij nuk i pëlqen padija; atij nuk i pëlqen të sëmuret. Po të mos të gjejë përgjigjet e sakta të kënaqshme, ai do të bëjë një jetë gjithë ankth dhe nuk do të gjejë askund mirësi ose strehë. Në qoftë se njeriu qëndron në të panjohurën, ai do të mbetet në errësirë dhe në padije. Dhe atij nuk i pëlqen as njëra as tjetra.

Allahu thotë: "A barazohet i vdekuri që Ne e ngjallëm dhe i dhamë dritë, me të cilën ecën midis njerëzve me atë që është në errësirë e nuk mund të dalë prej saj?! Kësisoj, jobesimtarëve u duken të bukura veprat që bëjnë¹."

A është jeta qëllim

Në jetën e tij, njeriu shkon nga fëmijëria tek adoleshenca, pastaj te rinia, te burrëria, te mosha e mesme, te pleqëria etj... Secila nga këto etapa ka veçoritë e veta, gjatë të cilave njeriu ka një sjellje të caktuar ose prirje të caktuar. Kur është i ri, është i dhënë pas lojës. Kur bëhet

¹. En'am (Surja 6), ajeti 122.



më i madh, u kthehet veprimtarive, argëtimeve dhe zbavitjeve. Më vonë, atij i mbetet në mendje të ketë gjëra për vete, si rroba, makina e shtëpi dhe mrekullohet, gjithashtu, me bukurinë. Kur mbërrin moshën e mesme, ai nis të mburret para shokëve për prejardhjen e familjes së tij, shkollimin e tij, pozitën, paránë etj... Kur plakët, ai jepet më shumë pas pasurisë dhe fëmijëve.

Për këtë Allahu i Gjithëfuqishëm thotë: **"Ta dini se jeta në këtë botë nuk është tjetër veçse lojë, dëfrim e zbukurim, si dhe mburrje ndërmjet jush e rivalitet për më shumë pasuri dhe fëmijë..."** Pastaj Allahu qartëson: **"Ajo i shëmbëllen bimës, e cila pas shiut rritet dhe i gëzon bujqit, por më vonë zverdhet, thahet dhe mbetet pa vlerë..."** Kjo ndodh në jetë. **"Në Botën Tjetër ju presin vuajtje të mëdha ose falja e Allahut dhe kënaqësia e Tij; jeta në këtë botë është vetëm kënaqësi e rreme²."**

Jeta e kësaj bote, me të gjitha gëzimet e saj është e vdekshme, ashtu si gjithçka tjetër në të. Nëse ju nuk besoni, shikoni rreth jush: nënën tuaj, babanë tuaj, dhe gjyshin tuaj. Të gjithë ishin fëmijë, adoleshentë, të rinj... Sot përpara jush ata janë të gjithë të vjetër dhe të moshuar. Flokët u janë bërë të bardhë si bora dhe fytyrat kanë gjurmët e kohës. Sot janë të dobët dhe të sëmurë. Ku janë rinia, bukuria, fuqia, energjia e tyre? Ku është shëndeti i

². El Hadid (Surja 57), ajeti 20.



tyre? A u ka lënë jeta në këtë botë ndonjë gjë? A kanë pasuri, familje e fuqi t'i mbrojnë nga pleqëria? Jo, absolutisht jo.

Tani, a do t'ju pëlqente të bëheshit njëlloj si ata që harxhuan kot jetët e tyre dhe jeta i ka flakur, apo do t'ju pëlqente të mësonit çfarë ju ka ndodhur të tjerëve? Kjo është jeta. Atëherë, a ia vlen t'i harxhosh vitet dhe energjitë e tua për të fituar atë që ajo duhet të ta japë pa i kushtuar kujdes jetës reale? Imam Khomeini thotë: *"Të gjitha mësimjet dhe tërheqjet, të përpjetat dhe të tatëpjetat në jetë ikin sa hap e mbyll sytë. Ne të gjithëve na shtypin rrotat e kohës... Unë kam ardhur në këtë përfundim nga vëzhgimet e mia për shumë klasa të ndryshme: ata që janë të krimbur në pará, kanë më shumë shqetësime të brendshme dhe psikologjike; ata kanë shumë shpresa dhe pritshmëri që nuk i kanë përmbushur dhe nuk i kanë arritur; të tilla shqetësime rrahin më shumë dhe madje, djegin zemrat e tyre."*³ Kurse imam Sadiku (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) thotë: *"Jeta është si uji i detit: sa më shumë të pish, aq më shumë keni etje, derisa të ndërroni jetë."*⁴

Ata që i rrëmben jeta plotësisht, ata që e gërryejnë jetën dhe ata që e kanë bërë jetën synimin e tyre të fundit, Allahu i përshkruan kështu: **"Rasti i tyre është si rasti i atij që i zgjat duart tek uji, për t'i ardhur te goja, por ai**

³. Gnostic Commandments.

⁴. El Kafi, Part II, f. 136.



kurrsesi nuk i vjen...⁵ Jeta kurrë nuk e ngop urinë e nuk e meriton kurrë të kthehet qëllim në vetvete dhe ne pashmangshmërisht do ta lëmë atë më në fund.

Cila është rruga e shpëtimit?

E vërteta e padiskutueshme: Jeta e vërtetë është ajo e shpirtit dhe jo ajo e trupit. Që ta mbërrish këtë jetë, i Gjithëfuqishmi thotë: **"O ju që keni besuar! Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit kur ju thërret drejt asaj që ju jep jetë!"**⁶ Jeta për të cilën na ftojnë Allahu dhe i Dërguari i Tij, është jeta e vërtetë. Ajo është plot gëzime dhe ne do ta jetojmë në përjetësi. Ajo është jeta ku ne do ta njohim, vërtet Krijuesin tonë. Ai është e Vërteta Absolute. Njohja e Allahut është qëllimi dhe synimi ynë.

Imam Sadiku (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) thotë: *"Po ta dinin se ç'të mirë ka njohja e Allahut, ata nuk do t'i rroknin me sytë e tyre atë që Allahu ua ka dhënë armiqve të tyre për të mirat e kësaj jete dhe jeta e tyre do të ishte e barabartë me asgjë më shumë sesa ajo në të cilën ata do të vinin këmbën. Ata do të kënaqeshin me dijen e tyre për Allahun e Gjithëfuqishëm dhe do*

⁵. Er Rrad (Surja 13), ajeti 14.

⁶. En Fal (Surja 8), ajeti 24.



të lumturoheshin me Të, sikur të ishin ende në Xhenet me robtë më të afërt e më besnikë të Allahut..." "Përse o imami ynë", - thonë disa: "Sepse njohja e Allahut të largon nga vetmia", - thotë imami. Ne nuk do të jemi kurrë të vetëm ose të vetmuar. **Allahu është Shoku ynë në çdo tëhuajtje, sepse Ai është me ne, Ne e ndiejmë praninë e Tij dhe e njohim Atë. Ai është drita në çdo errësirë. Prandaj ne asnjëherë nuk do të kemi frikë në errësirë. Ai është fuqia e çdo njeriu të dobët dhe shërimi i të gjitha sëmundjeve.**⁷ Ne kurrë nuk do të vuajmë nga asnjë sëmundje. Atëherë, kush në këtë botë do ta parapëlqente një jetë që rrëshqet dhe shkatërrohet përpara asaj të përjetshmes? Kush do ta parapëlqente jetën përpara Allahut, përveçse ai që është i marrë? Imam Sadiku (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) thotë: *"Zemra e atij që parapëlqen këtë jetë, ka tri veçori: brengë të përhershme, shpresa të paarritura dhe dëshira të papërmbushura asnjëherë."*⁸

Përfundim:

Ju, i nderuar lexues, duhet të ndaloni dhe të meditoni për një çast: A do të zgjidhnit jetën e vërtetë dhe

⁷. El Kafi, Part II, f. 247.

⁸. El Kafi, Part II, f. 320.



kënaqësinë e sigurinë e përjetshme dhe të vinit tek Allahu për të kërkuar mëshirën e Tij, apo do ta harxhonit kot jetën tuaj në kënaqësi të përkohshme, të cilat asnjëherë nuk jua shuajnë etjen? A duhet ta gjeni rrugën për tek Allahu, apo të endeni kot në mugëtirat e jetës, duke shpresuar nga një epsh te një tjetër, derisa Allahu të japë urdhrin që jeta juaj të mbarojë? Vendosni! Vendimin e keni vetëm ju.

Përmbledhje:

Njeriu nuk mund të rrijë tek e panjohura sepse, nëse rri tek e panjohura, ai do të mbetet në errësirë dhe në padituri. Dhe ai nuk e do as njërën as tjetrën.

Jeta e kësaj bote, me të gjitha gjërat e saj e me të gjitha gëzimet e saj është e vdekshme. Jeta kurrë nuk e ngop urinë e nuk meriton kurrë të kthehet qëllim në vetvete dhe ne pashmangshmërisht do ta lëmë atë më në fund. E vërteta e padiskutueshme: Jeta e vërtetë është ajo e shpirtit dhe jo ajo e trupit. Qëllimi ynë i vërtetë duhet të jetë njohja e Allahut, e Mëshiruesit dhe gjetja e Rrugës së Tij.

Pyetje:

A e përfaqëson jeta qëllimin e njeriut?



Cila është jeta për të cilën ne jemi ftuar nga Allahu dhe i Dërguari i Tij?

Thoni *i Vërtetë* ose *i Gabuar* në pohimet e mëposhtme:

- a. Njeriu duhet ta dijë përgjigjen për çdo pyetje. ☐ ☐
- b. Kush ka lumturi në këtë jetë, nuk do ta ketë në Jetën Tjetër. ☐
- c. Çdo i varfër bën një jetë të mjeruar, kurse çdo i pasur bën një jetë të lumtur. ☐ ☐
- ç. Njeriu e do jetën sepse ai beson që ajo është e përkryer dhe pa të meta. ☐ ☐

LEXIM PLOTËSUES

Kurrë mos e përçmoni dhe mos e fyeri një besimtar

Haxhi Sheik Muhamed Bakir Sheikh El Islami i madh (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon: "Kur mbaronte falja me xhemat, unë i jepja dorën kujtdo që ishte djathtas dhe majtas meje. Një ditë, kur përfundova faljen pas të ndjerit Mirza el - Shirazit (Allahu e lartsoftë pozitën e tij!), u



ktheva dhe i dhashë dorën një burri, që ishte ulur në të djathtë - një vëlla mysliman shumë i edukuar. Një fshatar që ulur majtas meje. Mua nuk më pëlqente ai dhe nuk ia dhashë dorën.

Unë menjëherë fajsova veten për mendimin përçmues që pata dhe thashë me vete: "Ky njeri që unë përçmoj, mund të jetë besimtar, që Allahu e nderon. Menjëherë u ktheva dhe shtrëngova duart me të me gjithë mirësjelljen. Në çast ndjeva myshkun që nuk ishte si ai që dija unë. U mbusha me gëzim e lumturi dhe e pyeta burrin: A mbani myshk? "Unë kurrë nuk mbaj myshk", - u përgjigj burri. Atëherë, e kuptova se era e mirë ishte shpirtërore dhe se fshatari ishte eulija. Që atëherë unë vendosa të mos e shikoja me përçmim asnjë besimtar.



Mësimi dy

A E NJIHNI ALLAHUN

Cilat janë rrugët për ta njohur Allahun?

Si mund ta gjejmë rrugën e drejtë për tek Allahu? (Me mendje / me logjikë)

Si mund ta gjejmë rrugën e drejtë për tek Allahu? (Me shpirt)

Hyrje:

Pasi mësuam në mësimin e kaluar se qëllimi i ekzistencës së njeriut është të njohë Allahun e Gjithëfuqishëm dhe të lidhet me Atë, duhet t'u përgjigjemi pyetjeve të mëposhtme:



Rruga për ta njohur Allahun

Njeriu mund t'i identifikojë gjërat që e rrethojnë dhe t'i dallojë ato. Ato identifikohen me shqisën përkatëse: gjërat që shihen me sy; gjërat që dëgjohen me vesh; gjërat që preken me dorë; gjërat që nuhaten me hundë. Por njeriu nuk mund të identifikojë një skenë të spikatur natyre me të dëgjuar. Njeriu nuk mund të dallojë me sy këngën e bilbilit nga krakërimën e sorrës etj. Pra, çdo gjë e njohur ka një shqisë identifikuese. Por çfarë i dallon këto shqisa.

Përgjigje: Është intelektu ai që na është dhënë nga Allahu. Meqë kemi mendje, ne jemi parapëlqyer nga të gjitha kafshët. Ne, për shembull, nuk e vëmë dorën në zjarr, nuk pimë helm dhe nuk e vrasim veten me thikë sepse kemi mendjen, që nuk na lë t'i bëjmë veprime të tilla, që na çojnë në humbje. Prandaj, mendja e njeriut është fuqia me të cilën ai i percepton, i kontrollon dhe i identifikon gjërat. Nëse vetë shqisat nuk mund ta gjejnë rrugën për tek Allahu, atëherë a do të mund ta gjejë mendja Allahun?



Mendja të drejton tek Allahu

Allahu thotë: "A ka dyshim për Allahun, Krijuesin e qiejve dhe të Tokës?"⁹ Po të shihnit një shtëpi tërheqëse, të ndërtuar bukur, a do të dyshonit se një ndërtesë e tillë nuk është bërë nga një projektues krijues? Po të shihnit tym që del nga një vend i caktuar, ose që keni ndier diçka që po digjet, a nuk do të dyshonit për një çast se ka një zjarr që nxjerr tym dhe që bie erë?

Kur ecni në bregdet dhe shihni gjurmë në rërë, a nuk do të dyshonit për një çast se dikush ka kaluar dhe i ka lënë këto gjurmë?

Tani, le të shohim përreth nesh: Qielli i zbukuruar me hënën dhe me yjet e tij në errësirë dhe planetet që lundrojnë në hapësirë për miliarda vjet në orbitat e tyre të paracaktuara saktë. Planetet do të përplaseshin dhe do të shkatërroheshin, në qoftë se do të ndryshonte shpejtësia dhe orbita e tyre. Tani le të bëjmë pyetjen: Kush i ka përlllogaritur largësitë, orbitat dhe shpejtësitë e këtyre planeteve? A dyshoni se ka një Fuqi projektuese të jashtëzakonshme që është kaq e zgjuar dhe e saktë, që ta ketë përlllogaritur, organizuar dhe t'i ketë bërë këta trupa

⁹. Ibrahim, (Surja 14), ajeti 10.



qiellorë? Shikoni shiun dhe lidhjen e tij me tokën dhe si e rigjallëron atë! Shikoni shiun, si i lulëzon bimët e tokës që ne hamë! A do të besonit sikur një njeri t'ju thoshte se ai dyshon se Dikush i ka krijuar këto gjëra dhe i ka bërë të mundshme për ne?

Kush i ka lidhur këto gjëra njëra me tjetrën?

Njeriu e punon tokën, e plehron dhe e mbjell, duke përdorur makineri dhe kafshë. Bie shiu dhe i ujit farat në tokë. Farat mbijnë dhe bëhen bimë. Pastaj era dhe kandrrat e çojnë pjalmin nga një bimë te një tjetër dhe formohen frutat e këndshme. Kush i ka krijuar të tilla lidhje dhe marrëdhënie - bujk, tokë, shi, lule, bimë dhe kandrra? Përse a dyshoni se nuk është Allahu pas gjithë këtyre?! "**A ka dyshim në qenien e Allahut, Krijuesin e qiejve dhe të Tokës?**" Mendja na thotë se është një Krijues i Madh, i Fuqishëm dhe i Urtë pas gjithë këtyre, që ka krijuar trurin tonë për të besuar në dijen e padiskutueshme, me të cilën ne gjejmë rrugën për të besuar në Allahun. Ne nuk përdorim sytë për të besuar në Allahun, por përdorim trurin. Lexojmë ajetet e 'shenjave' që dëshmojnë me të gjithë fuqinë, që Allahu i ka krijuar ato: "**Shpejt Ne do t'u**



tregojmë atyre Shenjat Tona në zonat (më të largëta të Tokës)..."

Shpirti na drejton për tek Allahu

Le të plotësojmë ajetin që u përmend më lart: "...Dhe në shpirtrat e tyre, derisa t'u bëhet e qartë se kjo është e Vërteta..." ¹⁰ Por si e njohin shpirtrat Krijuesin e tyre? Allahu, Zoti ynë, kurrë nuk i ka lënë ata në mëdyshje dhe të pësjtjelluar në njohjen e tyre. Përkundrazi, Ai na e ka treguar rrugën në Kur'anin e Shenjtë. Zoti ynë thotë: "**O njerëz! Ju jeni të varfër e nevojtarë për Allahun, kurse Allahu s'ka nevojë për asgjë dhe është i Denjë për çdo lavdërim.**" ¹¹

Nuk e sheh ti vëlla bashkë me mua se ne njerëzit kemi nevojë të marrim frymë? Dhe po të mos kishim ajër, ne do të mbyteshim dhe do të vdisnim. Ne kemi nevojë për ushqim për të jetuar ose ndryshe, do të vuanim urie dhe do të vdisnim. Ne duam sy të shohim, veshë të dëgjojmë, duar të ndërtojmë, të punojmë, të mbjellim. Ne duam këmbë të ecim...

¹⁰. Fussilet (Surja 41), ajeti 53.

¹¹. Fatir (Surja 35), ajeti 15.



Ne na duhen të gjitha këto. Nevoja na bën ne të lëvizim duart për të punuar dhe këmbët për të ecur, sepse ne jemi të dobët..., ne vuajmë urie..., ne kemi etje..., ne do të mbeteshim pa petk në trup në të nxehtë dhe në të ftohtë. Pra, nevoja dhe mospasja na shtyn të përpiqemi për të plotësuar nevoja dhe instikte të tilla.

Kështu, ne kërkojmë ushqim për të ngrënë, ujë për të pirë dhe rroba për t'u mbrojtur nga i ftohti dhe i nxehti. Siç është nevojtar trupi ynë, po ashtu është i varfër dhe nevojtar edhe shpirti ynë. Ne kemi nevojë për dije, fuqi dhe aftësi, lartësi dhe fisnikëri, butësi dhe simpati, dashuri dhe bukuri. Edhe sikur stomaku ynë të jetë ngopur, ne përsëri do të kemi dëshirë: "Kush do të më japë mua?" Kush do të ma heqë frikën në errësirën e natës? Kush do të më rrijë pranë, kur jam vetëm? Kush do të jetë me mua, kur s'kam të afërm? Përgjigjja vjen thellë nga shpirti: Mos kërko të ta plotësojnë nevojën ata që janë si ti, ata që janë nevojtarë dhe të varfër si ti, ata që vuajnë si ti. Ti, unë dhe i gjithë njerëzimi dhe krijesat e tjera janë nevojtare dhe të varfra. Ne vuajmë nga varfëria. Ne kemi nevojë për dikë, pasuritë e të cilit nuk mbarojnë kurrë për t'i plotësuar nevojat tona të përhershme. Ne jemi shumë të varfër dhe kemi nevojë për dikë që ka gjithçka. Kush është ai? Përgjigjja vjen nga thellësitë e zemrës sonë: Ai është Allahu, i Pasuri Absolut, pasuria dhe bujaria e të Cilit nuk kanë kufi.



Dëgjoni bashkë me mua lutjen (duanë) e imam Sexhadit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!): "O Zot! Ti e ke dalluar Veten nga krijesat tuaja. Ti nuk ke nevojë për ta, kurse ato janë të varfra dhe kanë nevojë për Ty. Ai që përpiqet të kërkojë nga Ti për nevojat e tij dhe për të shpëtuar nga varfëria, ka ndjekur rrugën e drejtë. E kundërta, ai që kërkon ndihmë për nevojat e tij nga dikush tjetër ose nga ndonjë krijesë tjetër juaja, asnjëherë nuk do ta gjejë atë, që do dhe asnjë nga dëshirat e tij nuk do të plotësohen. Ai do të jetë i privuar."¹² Në testamentin e tij për djalin e tij, Ahmedin, imam Khomeini (Allahu i mëshiroftë shpirtrat e tyre!) thotë: "...Dhe po t'u drejtoheshit të gjitha llojeve të krijesave për t'ju ndihmuar, të gjitha do të përgjigjeshin instiktivisht se ato kanë nevojë vetë për Atë, i Cili nuk ka nevojë për askënd dhe që është i përkryer në ekzistencën e Tij..." Dhe: "Lidhuni me pasurinë absolute, Allahun deri kur të mos keni nevojë për asgjë tjetër dhe lutjuni Allahut t'ju udhëzojë të mbërrini në sheshin e tij të shenjtë..."¹³ Kështu i dashur vëllai im, shikoje veten dhe pyete veten: A je i varfër dhe nevojtar apo jo? Ajo me siguri do të përgjigjet me po. Atëherë, ftoje atë që ta njohë me të Pasurin e të pasurve dhe me më Bujarin e të gjithëve, që është Allahu, sepse kur e njeh Allahun, je njeriu më i pasur në botë.

¹². El Sahife El Sexhadija .

¹³. Meeting Date - Merciful Manifestations , f. 54 , 55 .



Përmbledhje:

Shpirti i njeriut mund t'i riidentifikojë gjërat që e rrethojnë dhe mund t'i dallojë ato. Mendja që na është dhënë nga Allahu është forca që e bën njeriun t'i perceptojë gjërat kur i përdor ato. Shqisat e njeriut janë të paafta ta arrijnë Allahun. Këtë mund ta bëjë mendja nëpërmjet ajeteve për 'shenjat', që dëshmojnë me gjithë ekzistencën e tyre se Allahu i ka krijuar ato.

Pyetje:

Përmendni shkurt rrugët me të cilat mund të njihet Allahu.

Tregoni një hadith i thënë nga imam Sadiku (paqja qoftë mbi të!), i cili sqaron se njeriu është i varfër dhe ka nevojë për Allahun.

Thoni *i Vërtetë* ose *i Gabuar* në pohimet e mëposhtme:

- a. Sa më inteligjent bëhet një njeri, aq më i afërt bëhet me Allahun. ☐ ☐
- b. Madhësia e universit është provë për madhësitinë e Krijuesit. ☐ ☐



c. Varfëria e një njeriu, si edhe e të gjitha krijesave të tjera është shenjë e pasurisë së Allahut ☐ ☐

ç. Njeriu i largohet Allahut sepse mendon se Ai është i domosdoshëm. ☐ ☐

LEXIM PLOTËSUES

Histori miqësie

Midis Sejjid Muhamed Baker el Mirdamad dhe Sheikh Baha'i (mëshira e Allahut qoftë mbi shpirtrat e tyre!) kishte një miqësi dhe vëllazëri të rrallë, të ngushtë dhe të veçantë. Thuhet se Shah Abbas Safaui ishte në një vargan, i shoqëruar nga el Mirdamad dhe el Baha'i. Ata rrallë ndaheshin nga njëri-tjetri. Në dallim nga Sheikh Baha'i, el Mirdamad kishte trup të madh. Sulltani deshi të provonte miqësinë e tyre. Kështu, ai erdhi te Mirdamadi, i cili ecte me kalë në fund të varganit. Për arsye të trupit të tij të madh, Mirdamadi ishte kaq i lodhur, sa që dukej në fytyrë, kurse el Baha'i çante erën në krye të varganit. Sulltani i tha: "O zotëri! A e sheh Sheikhun, që i prin varganit e s'pyet për ty fare?" Sejjid u përgjigj: "O mbret! Kali i Sheikhut nuk mund të ecë ngadalë sepse ai e di kë ka mbi shpinë (një



dijetar fetar të jashtëzakonshëm)." Pastaj sulltani erdhi te Sheikh Baha'i dhe i tha: "Po të kthesh kokën, do të shohësh se Sejjidi i është bërë barrë varganit me gjithë atë trup të madh. Një dijetar fetar duhet jetë, vërtet si ti: "shpirtërisht i lartësuar dhe me trup jo të madh." "Jo, o mbret. Kali është i lodhur sepse nuk mund ta mbajë diturinë mbi shpinën (ishte fjala për Sejjid el Mirdamadin). Edhe malet nuk mund ta mbajnë mbi shpinë një dituri të tillë", - u përgjigj Sejjidi. Kur sulltani e kuptoi miqësinë e ngushtë që kishin ata, zbriti nga kali dhe bëri sexhde para Allahut për ta falënderuar Atë për këtë mirësi të madhe.

Ka shumë histori për miqësinë dhe qëllimet e tyre. Ata qenë dy dijetarë të pastër dhe të sinqertë.



Mësimi tre

ALLAHU NA FTON PËR TEK AI

Si na fton Allahu?

Përse na fton Allahu?

Për çfarë është kjo ftesë?

Si na fton Allahu?

Allahu na ka krijuar dhe na ka përcaktuar qëllimin e krijimit tonë, kur thotë: **"Xhindet dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të më adhurojnë Mua."**¹⁴ Kurse në hadithin kudsi thuhet: *"Unë qeshë thesar i fshehur dhe desha të më njihnin; prandaj Unë e krijova çdo krijesë, në mënyrë që të mund të më njohë..."* Për Allahun që na ka krijuar, ne jemi të panevojshëm. Ai nuk ka nevojë të na krijojë. Ai është Bujari pa kufi. Ai na jep çfarë duam dhe çfarë është në Dorën e

¹⁴. Edh Dharijat (Surja 51), ajeti 56.



Tij. Njohja e Allahut është nga mirësitë më të mëdha që na është dhënë. Allahu na ka krijuar për këtë mirësi të madhe dhe për këtë qëllim të madh. Ai na do ne, prandaj na e ka dhënë këtë mirësi: **"Kur robtë e Mi (besimtarë) të pyesin për Mua, (thua ju se) Unë jam afër, i përgjigjem lutjeve të lutësit, kur ai më lutet Mua..."**¹⁵

Allahu është afër, por robtë e tij janë larg... **"Ti nuk e fsheh Vetën nga krijesat e Tua, në qoftë se veprat e tyre të këqija nuk i bllokojnë ato nga Ti."**¹⁶ Madje, Allahu na fton ta njohim Atë dhe na fton ta duam Atë. Ai na fton t'i afrohem Atij shpirtërisht dhe ta shtojmë dijen tonë për Të dhe ta gëzojmë këtë dije.

Allahu kurrë nuk lë asgjë pa dëshmi në të, që flet për aftësinë, urtësinë, diturinë dhe bujarinë e Tij. Le ta dëgjojmë Imam Zein el Abidin (Paqja e Allahut qoftë mbi të!), kur thotë: *"Me Ty unë të njoh Ty. Ti më tregove dhe më drejtovë tek Ti. Ti më ftove tek Ti. Po të mos ishe Ti, unë nuk do të të njihja Ty."*¹⁷ E gjithë ekzistenca na fton tek Allahu dhe nga thellësitë tona një zë i brendshëm na fton tek Allahu: *"Dija ime, o Zoti im është ajo që më drejton për tek Ti dhe dashuria ime është ndërmjetësuesi im për tek Ti dhe unë besoj te dëshmia ime me udhëheqësinë Tënde dhe ndihem komod për*

¹⁵. El Bekare (Surja 2), ajeti 186.

¹⁶. Du'aa Abi Hamzah al Thumali Al Mafatih.

¹⁷. Du'aa Abi Hamzah al Thumali.



ndërmjetësuesin tim me ndërmjetësinë Tënde." ¹⁸ Gjithçka brenda kësaj ekzistence na fton tek Allahu dhe na udhëheq për tek Ai: lulja, bleta, atomi, një galaktikë brenda një universi dhe thellësia e shpirtit tonë. Po t'i ndjekim këto gjëra, do të gjejmë se të gjitha ato janë ftesa të vulosura me vulën e Allahut dhe janë prova për tek Allahu. Le të dëgjojmë lutjen e Imam Huseinit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) në Ditën e Arafatit: "O Zot! Nga ndryshimi i gjërave dhe lëvizja e këtyre gjërave unë mësova se qëllimi Yt është të dish gjithçka për mua, në mënyrë që të mos jem i pavetëdijshëm për diçka për Ty." ¹⁹

Përse na fton Allahu?

Allahu është Zoti i të gjitha botëve, domethënë Ai administron dhe drejton punët e njerëzve dhe universi është vetëm në Dorën e Tij. Ai ka rregulluar dhe ka organizuar universin, ka krijuar Diellin dhe Hënën dhe i ka bërë të punojnë për ne. Ai mban qiejt, i bën ata të lëshojnë shi dhe të rriten bimët. Për çdo gjë që ne kemi nevojë, Allahu e ka bërë të punojë për ne. Allahu është

¹⁸ . Du'aa Abi Hamzah al Thumali.

¹⁹ . Bihar Al Anuar, vol. 95, f. 225.



Zoti, domethënë, lindja e njerëzve dhe e qenieve të tjera është në Dorën e Tij. Ai na udhëheq për të arritur qëllimin e ekzistencës sonë: lumturinë.

Qëkur jemi krijuar dhe jemi formuar brenda mitrave të nënave tona e deri në vdekje, Allahu kujdeset për ne dhe na i plotëson nevojat tona fizike, pa i harruar nevojat tona shpirtërore.

Ashtu siç na ka dërguar shiun, na ka dërguar udhëheqësinë, librat e shenjtë. Ashtu siç ka krijuar Diellin që ndriçon dhe Hënën që ndrit, Ai na ka dërguar Profetët, të Dërguarit dhe Imamët. Ashtu siç na jep ushqim dhe ujë, siç thotë Ibrahim (paqja e Allahut qoftë mbi të!), "*Ai që më jep ushqim dhe ujë dhe kur jam sëmurë, është Ai, i Cili më shëron mua*" ²⁰, është Ai, i Cili na udhëzon, na edukon dhe na pastron. **"Prandaj friksojuni Allahut, sepse është Allahu Ai që ju mëson ju."** ²¹ "... Por Allahu pastron këdo Ai..." ²² Ja përse lexojmë "Zoti i atyre që bëjnë sexhde": **"O Zot! Unë jam i riu, të cilin Ti e ke lindur dhe unë jam i padituri, të cilin Ti e ke mësuar dhe unë jam i paudhëzuari, të cilin Ti e ke udhëzuar..."** ²³ Në saje të mëshirës, dhembshurisë dhe urtësisë së Allahut dhe meqë Ai është Zoti, që është Mësues, Ai na fton ta njohim Atë

²⁰. Esh Shuara (Surja 26), ajeti 79 - 80.

²¹. El Bekare (Surja 2), ajeti 282.

²². En Nur (Surja 24), ajeti 21.

²³. Du'aa Ebi Hamzah al - Thumali.



dhe t'i afrohemi sa më shumë Atij me mendjet dhe me zemrat tona: **"O ju që keni besuar! Përgjigjuni Allahut dhe të Dërguarit të Tij, kur Ai ju fton ju për atë që do t'ju japë jetë..."**²⁴ Pra, Allahu na fton te jeta; na fton të jemi ndër ata që jetojnë...

Për çfarë është ftesa?

Le ta shohim edhe njëherë ajetin e mëparshëm: **"O ju që keni besuar! Përgjigjuni Allahut dhe të Dërguarit të Tij, kur Ai ju fton ju për atë që do t'ju japë jetë..."** A nuk na bën ky ajet të pyesim dhe të habitemi? Përse, a nuk jemi të gjallë?! Atëherë, cili është kuptimi **"për atë që do t'ju japë jetë..."**? Le ta shikojmë jetën që bëjmë. Me atë vështrimin tonë të shkurtër, shikojmë se shenjat e jetës janë rrahjet e zemrës dhe frymëmarrja. Ky është gjykim mjekësor. Të tjerët mendojnë se shenjat e mbijetesës janë ushqimi, uji dhe martesë. Po për Allahun, i Cili ka krijuar jetën dhe vdekjen, cila është jeta e vërtetë? A është jeta e kafshëve? Allahu gjithmonë e ka mohuar këtë lloj jete.

Ajo është jeta e atyre që e mohojnë Besimin. Ajo është jetë shtazarake. Jeta e vërtetë është ajo e mendjes me vetëdije dhe me shpirt. Përndryshe, kushdo që dëgjon dhe

²⁴. El Enfal (Surja 8), ajeti 24.



nuk përfiton nga ky dëgjim, është i shurdhët. Dhe kushdo që shikon dhe nuk e përdor këtë shikim, është i verbër. Kështu është edhe për këdo që nuk përfiton asnjëherë nga jeta e tij dhe nuk kthehet nga drita e udhëheqësisë së Allahut e nuk i dëgjon asnjëherë fjalët e Tij. Për Allahun, ky lloj njeriu është i vdekur. **"Sigurisht që ti (Muhamed), nuk mund t'i bësh të vdekurit të dëgjojnë, as nuk mund t'i bësh të shurdhrit të dëgjojnë thirrjen tënde, kur të kthejnë shpinën."** ²⁵ Një shpirt që ka humbur Besimin dhe që nuk ka përfituar kurrë nga thirrjet e udhëheqësisë së Allahut, është, vërtet i vdekur. Dhe çfarë vdekjeje! Prandaj, ne jemi të vdekur në qoftë se nuk i përgjigjemi asnjëherë thirrjes së Allahut. Ne jemi të vdekur nëse nuk i përgjigjemi asnjëherë ftesës së Allahut dhe nëse nuk përfitojmë asnjëherë nga dritat e udhëheqësisë së Allahut.

Që ta kthejmë vdekjen tonë në jetë të vërtetë, ne duhet të shohim vetet tona dhe t'i bëjmë vetet tona që t'i dëgjojnë fjalët e Allahut dhe fjalët e të Dërguarit të Tij. Kjo është mënyra se si ne ta lëmë errësirën e paditurisë dhe të vdekjes dhe të marrim dritën e diturisë dhe të jetës: **"A mundet që ai që ishte i vdekur dhe Ne i dhamë jetë dhe një dritë, ku ai mund të ecë ndërmjet njerëzve, të jetë si ai që është në thellësitë e errësirës, nga e cila ai kurrë nuk**

²⁵. En Neml (Surja 27), ajeti 80.



mund të dalë?" ²⁶ Sa jetë ka ndrequr vdekja sepse në fakt, ato ishin vetëm torturë, ngaqë ata i kishin kthyer shpinën thirrjes së Allahut. Ai që bën një jetë të tillë, kurrë nuk i dëgjon ajetet e udhëheqësisë së Allahut, nuk e ndien dhembjen e dënimit ose nuk largohet nga ajo që bën: **"Kushdo që i kthen shpinën Fjalës Sime, do të ketë jetë të mjeruar dhe Ne, në Ditën e Ringjalljes, do ta ringjallim të verbër."** ²⁷ Vdekje të tjera do të ndryshojnë e do të bëhen jetë. A nuk ka thënë Allahu, **"Kushdo, mashkull apo femër që kryen vepra të mira, duke qenë besimtar, Ne do t'i japim atij një jetë të re, një jetë që është e mirë dhe e pastër..."**? ²⁸ Allahu na fton të jetojmë një jetë të mirë, që është kaq e ndryshme nga jeta shtazarake. Është një jetë, në të cilën ne kemi sigurinë dhe shpëtimin. Është një jetë që është e përjetshme sepse atëherë, do të na mbulojë dhe do të na bekojë dashuria e Allahut dhe do t'i afrohem Atij më shumë, Atij i Cili ka në Dorën e Tij jetën dhe vdekjen tonë.

²⁶ . El En'am (Surja 6), ajet 122.

²⁷ . Ta Ha (Surja 20), ajeti 124.

²⁸ . En Nahl (Surja 16), ajeti 97.



Përfundim:

I dashur lexues! Nëse Allahu, Zoti i trupave tanë, është Ai i Cili na jep ushqimin dhe gjërat e domosdoshme dhe Ai i Cili është Zoti i mendjeve tona, që na mëson dhe na udhëzon, atëherë a nuk e meriton Ai ta dëgjojmë Atë dhe t'i bindemi Atij? **"Thuaj: 'A mos vallë do të kërkoj unë tjetër zot, përveç Allahut, kur Ai është Zoti i gjithçkaje? Kushdo që bën diçka, e bën për vete: askush nuk ngarkohet me barrën e tjetrit. Në fund të gjithë do të ktheheni te Zoti juaj dhe Ai do t'ju tregojë të vërtetën e kundërshtive që kishit mes jush.'"**²⁹

Përmbledhje:

Allahu na ka krijuar dhe na ka caktuar qëllimin në Librin e Tij të Shenjtë: Ai na ka krijuar që ta adhurojmë Atë. Allahu na fton ta njohim Atë, ta duam Atë dhe t'i afrohem i Atij. Kështu ne do të mund ta njohim më shumë Atë dhe t'i afrohem më shumë Atij.

²⁹. El En'am (Surja 6), ajeti 164.



Gjithçka brenda kësaj ekzistence na fton për tek Allahu dhe na drejton tek Ai: lulja, bleta, atomi, galaktika, universi. Të gjitha këto janë vulosur me vulën e Allahut.

Ne jemi të vdekur në qoftë se nuk i përgjigjemi thirrjes së Allahut dhe në qoftë se nuk përfitojmë nga dritat e udhëheqësisë së Allahut. Ne duhet të dalim nga errësira e padijes dhe e vdekjes në dritën e Allahut, të dijes dhe të jetës.

Pyetje:

A na fton gjithçka në univers të adhurojmë Allahun?

Cila është ajo jetë e mirë për të cilën na fton Allahu?

Thoni *i Vërtetë* ose *i Gabuar* në pohimet e mëposhtme:

- a. Qëllimi kryesor i krijimit të njeriut është të vijë dhe të hyjë në qiej. ☐ ☐
- b. Allahu ka sjellë të Dërguarit e Tij dhe drejtues që vetëm na këshillojnë. ☐ ☐
- c. Çdo njeri ka vetëm një jetë. ☐ ☐
- ç. Jeta, tek e cila na fton Allahu, është jeta e lumturisë së përjetshme. ☐ ☐



LEXIM PLOTËSUES

Sejjid Bahr el Ulum provon të ndjerin Narakki

I ndjeri Mulla Mehdi Narakki qe dijetar në shumë shkenca. Ai ka shkruar librin '*Xhami'a Al Saadat*' për moralin dhe pastrimin e vetvetes. Një kopje të këtij libri ia dërgoi Sejjid Bahr el Ulumit në Nexhefin e Shenjtë. Më vonë, ai udhëtoi për të vizituar xhaminë dhe vendprehjen e imam Aliut në Nexhef dhe hyri në qytet. Meqë kishte pozitë të lartë, e vizituan dijetarë. Kurse, Sejjid Bahr el Ulumi nuk shkoi ta vizitonte. Ditë më vonë, Narakki e vizitoi Sejjid Bahr el Ulumin, por ky nuk i kushtoi atij asnjë vëmendje. Përsëri, Narakki i bëri një vizitë Sejjid Bahr el Ulumit në shtëpinë e tij dhe ndenji një orë me të. Kjo vizitë nuk qe më e mirë se ato të mëparshmet, meqë Sejjid Bahr el Ulumi nuk i kushtoi shumë vëmendje Narakkit.

Një herë tjetër, Narakki e vizitoi Sejjid Bahr el Ulumin pa e pasur në mendje se kjo vizitë do të ishte më e mirë se vizitat e mëparshme. Kjo qe hera e tretë. Kur ai kërkoi lejen për të hyrë dhe për të takuar Sejjid Bahr el Ulumin, ky i dyti erdhi zbathur për ta pritur mikun e tij këtë herë, e



përqafoi ngrohtësisht mikun e tij dhe madje, e puthi atë. Pastaj me respekt e ftoi të hynte.

Sejjid Bahr el Ulumi nisi bisedën me Narakkin: *"Ju keni shkruar një libër të madh për moralin dhe për vetëpastrimin dhe më keni dërguar një kopje të tij. Unë e kam lexuar të gjithë librin me kujdes. Ai është, vërtet një libër shumë i rrallë dhe shumë i dobishëm. Unë nuk kam ardhur për t'ju parë qëkur mbërritët në Nexhef. Nuk ju kam kushtuar vëmendje qëllimisht sepse kam dashur t'ju provoj nëse, vërtet ju e zbatoni atë që keni shkruar në libër apo jo. Ju keni arritur nivelin më të lartë të vetëpastrimit. Ju, vetë jeni një libër i moralit që u tregoni rrugën të tjerëve me sjelljen tuaj dhe jo me librin tuaj."*



Mësimi katër

SI I PËRGJIGJENI THIRRJES SË ALLAHUT (PJESA I)

Pastroni zemrën dhe trupin tuaj

Si i përgjigjemi thirrjes?

Përse pastrohemi?

Si pastrohemi?

Hyrje:

Në mësimin e mëparshëm kemi mësuar që Allahu do nga ne të bëjmë dhe të jetojmë jetën e vërtetë, e cila nuk mund të arrihet në qoftë se nuk e njohim Atë dhe në qoftë se nuk e nderojmë vetveten duke u afruar më shumë tek Ai. Prandaj, Allahu na ka thirrur dhe ne duhet t'i përgjigjemi kësaj thirrjeje e t'i jemi mirënjohës Atij që na ka



nderuar ne dhe që kujdeset për ne. Kjo përgjigje, siç dihet, ka moralet dhe format e saj të pastrimit, faljet, këndimin e Kur'anit, duanë dhe lutjen etj... Tani le të fillojmë me pastrimin, për t'iu përgjigjur thirrjes së Allahut.

Si i përgjigjemi thirrjes?

Në mësimet e mëparshme kemi thënë që gjatë gjithë jetës sonë ne kërkojmë lumturinë e vërtetë. Ne kemi thënë, gjithashtu që e vërteta për të cilën ne jemi krijuar dhe kënaqësia më e madhe që do të arrijmë ndonjëherë është ta njohim Allahun dhe ta adhurojmë Allahun. Vërtet, kjo është krenaria dhe lumturia më e madhe. Siç u tha më parë, ne jemi thirrur nga Allahu për t'iu afruar Atij. Allahu na ka nderuar me këtë thirrje. Le të supozojmë sikur një njeri i madh, i përmendur na ka ftuar në një ceremoni. Gjatë ceremonisë ai duhet të nderohet. Mikut i pëlqen të fitojë miqësinë e mikpritësit. Për këtë arsye ai përpiqet të kujdeset për çdo gjë, në mënyrë që të ndihet i nderuar e ta takojë mikpritësin. Miku do të bëjë çmos të jetë sa më afër këtij njeriu. Dhe ai bën dush, parfumoset, vesh rrobat më të mira dhe shton ndonjë zbukurim që të duket sa më i përshtatshëm. Po ta dijë ai se mikpritësit nuk i pëlqen diçka, nuk do ta bëjë. Pra, Allahu na do t'i afrohem Atij të zbukuruar me gjithçka që e shton afërsinë dhe miqësinë



me Atë. Allahu na do të heqim gjithçka që do ta bënte Atë ta largonte fytyrën e Tij nga ne.

Atë që Allahu e do shumë nga ne, është ta pastrojmë veten nga të gjitha papastërtitë lëndore dhe jolëndore sepse ato na pengojnë që të afrohem i tek Ai. Prandaj Allahu na drejton te rruga që na çon te fitimi i dashurisë së Tij. Allahu thotë: "... **Dhe Allahu i do ata që e pastrojnë veten.**" Allahu i do ata që e qortojnë dhe e pastrojnë veten nga mëkatet. Allahu i do ata që e pastrojnë veten nga ndyrësitë dhe papastërtitë. Allahu thotë, gjithashtu: "**Në të ka njerëz të cilët duan të pastrohen dhe Allahu i do ata që e pastrojnë veten e tyre.**" ³⁰

Përse pastrohemi?

Gjërat lëndore janë imazhi i gjërave jolëndore. Për shembull, kur një njeri nuk kujdeset për trupin e tij, domethënë, kur nuk pastrohet, nuk lahet, pasojat janë këto:

Trupi do të bëhet i papastër dhe gjurmët e papastërtisë do të duken në organet e trupit.

Rrobat do të bëhen të papastra dhe ai do të duket i neveritshëm.

³⁰. Et Teube (Surja 9), ajeti 108.



Një erë e rëndë do të ndihet nga trupi dhe rrobat e tij.

Të gjitha këto çojnë në shtimin e mikrobeve, të sëmundjeve dhe pastaj të vdekjes; shto këtu edhe neveritjen që u sjell njerëzve të tjerë. Prandaj, pastërtia është shumë e rëndësishme për shpëtimin e trupit dhe të shpirtit. Ja përse Prijësi i besimtarëve (paqja e Allahut qoftë mbi të!) ka thënë: "*Pastroni rrobat, mos u hidhëroni dhe mos u mërzhisni sepse kështu jeni të pastrër për namaz!*"³¹

I Dërguari më i madh (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: "*Papastërtia është gjëja më e keqe që mund të bëjë një rob.*"³² Dhe: "*Pastërtia është gjysma e besimit.*"³³

Njeriu ka dy dimensione:

Paraqitjen e tij dhe trupin e tij.

Brendësinë e tij dhe shpirtin e tij.

Pastërtia e veshjes dhe e trupit është pastërtia e jashtme, kurse pendimi dhe puna e mirë janë pastërtia e brendshme. Siç duhet të kujdesemi për pastërtinë e trupit, të rrobave, të ushqimeve dhe të ujit, po kështu duhet të kujdesemi për dijen që marrim, me qëllim që të mos e infektojmë shpirtin tonë me mëkate dhe me vepra të këqija. Duke u pastruar nga papastërtia lëndore me ujë, ne e

³¹ . Truths, f. 215.

³² . Truths, f. 215.

³³ . Truths, f. 215.



mbajmë trupin të pastër dhe bëhemi dinjitarë kur takohemi me njerëz. Po kështu është pastrimi nga papastërtitë jolëndore.

Papastërtia që kërkon abdes ose gusul e pengon njeriun të jetë ndërmjet atyre që falen ose ndërmjet atyre që janë në Shtëpinë e Allahut në Mekë. Meqë Allahu e di ndikimin e gjumit, të urinimit, të marrëdhënies seksuale dhe të prekjes së trupave të vdekur dhe meqë Ai e di se këto na pengojnë ta adhurojmë Atë, Ai Vetë na mëson si t'i shmangim këto pengesa.

Imam Rizai (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) ka thënë për abdesin: *"Robi duhet të pastrohet sa herë qëndron përpara Allahut për sexhde, duke iu bindur kështu Atij në të gjithë urdhrat e Tij. Pastrimi fshin plogështinë dhe përgjumjen dhe pastron zemrën, për të qenë e përshtatshme për të dalë përpara Allahut."*

Si pastrohemi?

Papastërtia është dy llojesh: papastërti lëndore dhe papastërti jolëndore (rituale). Papastërtia lëndore: është papastërtia në trup ose në veshje: urina, feçet, gjaku, sperma, qeni, derri, pijet alkoolike, dhe trupat e vdekur. Papastërtia jolëndore (*hadath*), e cila ka të bëjë me veprime të caktuara të njeriut, ka dy aspekte:



Papastërtia që ka të bëjë me ritualin e vogël - veprime që kërkojnë pastrimin e vogël (abdesin), të tilla si, dremitja, urinimi, feçet, pavetëdijëshmëria etj.

Papastërtia që ka të bëjë me ritualin e madh - veprime që kërkojnë pastrimin e madh (gusul), të tilla si, marrëdhëniet seksuale, prekja e trupit të një të vdekuri etj.

Përfundim:

I dashur vëlla! Mëso nga ajo që ke parë në jetë! Jeta e vërtetë e njeriut është në zemrën e tij dhe në shpirtin e tij dhe jo vetëm në trupin e tij. Pastërtia e trupit dhe e veshjes janë një detyrim, por realiteti i njeriut është brenda zemrës së tij. Supozojmë se një njeri është shumë i kujdesshëm dhe i rregullt në mbajtjen e pastërtisë së tij të jashtme, por ka gjuhë vulgare dhe të turpshme, do të quhej ai i pastër? Nëse një njeri është dashakeqës dhe ka zemër të zezë, a do të quhej ai i pastër? Trupi dhe rrobat kanë pastërtinë e tyre, ndërsa zemra dhe shpirti kanë integritetin dhe dëlirësinë e tyre.

Prandaj le të jemi shumë të kujdesshëm në pastërtinë e zemrave tona! Le të mos i bëjmë ato ta harrojnë Allahun! Le t'i pastrojmë ato me ujin e pendimit! Le t'i rigjallërojmë gjithmonë ato me dije, me punë të mira dhe me besime e doktrina të vërteta! A e ke spastruar zemrën tënde me ujin e shlyerjes së fajit? A e ke spastruar gjuhën tënde nga



mëkati i thashethemeve dhe i paçiltërsisë? A e ke spastruar shpirtin tënd nga urrejtja, paragjykimi dhe zilia? Nëse e ke bërë këtë, atëherë ti je ndër të pastruarit e ndër të penduarit dhe ndër ata që i duan Allahu dhe i Dërguari i Tij (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!).

Si të merrni abdes?

Shkoni në vendin ku merret abdesi:

Lani fytyrën me dorën e djathtë vertikalisht nga floku në mjekër dhe horizontalisht sa hapësira midis gishtit të madh dhe gishtit të mesëm. Një herë është e mjaftueshme.

Lani krahun e djathtë nga bërryli deri te majat e gishtërinjve.

Lani krahun e majtë nga bërryli deri te majat e gishtërinjve.

Fshini me dorën e lagur majën e kokës nga sipër deri poshtë, të paktën sa gjerësia e gishtit.

Me pëllëmbën e lagur të dorës së djathtë fshini këmbën e djathtë nga maja e gishtërinjve deri te mesi i këmbës e deri te nyja.

Me pëllëmbën e lagur të dorës së majtë fshini këmbën e majtë nga maja e gishtërinjve deri te mesi i këmbës e deri te nyja.



Kujdes:

Para se të merrni abdes, sigurohuni që gjymtyrët të jenë të pastra dhe hiqni të gjitha materialet që e pengojnë ujin.

Uji duhet të jetë i pastër dhe i rrjedhshëm.

Lani fytyrën nga lart poshtë; lani duart nga bërrylat deri te gishtërinjtë. Veprimi i kundërt nuk lejohet.

Po kështu, edhe me kokën: nuk lejohet kalimi i dorës nga poshtë lart.

Përmbledhje:

Allahu do që të shkojmë tek Ai me zbukurimet tona dhe me gjithçka që e shton afërsinë dhe miqësinë me Të. Ai do që ne ta zhdukim gjithçka që e bën Atë të largohet nga ne. Prandaj ne duhet të shkojmë tek Allahu me gjithë pastërtinë tonë dhe pendimin tonë. Pastërtia e trupit është ndër gjërat që theksohet nga Allahu për të gjitha kohët, veçanërisht kur përpiqemi t'i afrohemi Atij dhe të komunikojmë me Të. **"... Allahu i do ata që e pastrojnë veten dhe pendohen."**



Pyetje:

10. Thoni tri hadithe për pastërtinë.
11. Cili është dallimi midis papastërtisë së vogël rituale dhe papastërtisë së madhe rituale (*hadath akbar* dhe *hadath asghar*)?
12. Thoni *i Vërtetë* ose *i Gabuar* në pohimet e mëposhtme:
 - a. Allahu na ka urdhëruar të marrim abdes dhe të bëjmë gusul për punë pastërtie. ☐ ☐
 - b. Eulijatë janë ata që nuk interesohen për trupin e tyre dhe kurrë nuk kujdesen për shpirtrin e tyre. ☐ ☐
 - c. Abdesi ka dy larje dhe dy fshirje. ☐ ☐
 - ç. Dora e djathtë dhe dora e majtë duhet të lahen tri herë. ☐ ☐

LEXIM PLOTËSUES

Plaku dhe dy djemtë e vegjël

Hasani dhe Huseini (Paqja qoftë mbi ta!) kaluan pranë një plaku që po merrte abdes. Ata panë se plaku po merrte abdes keq. Ata (Paqja qoftë mbi ta!) ishin fëmijë, por



rregulli fetar i detyronte ta udhëzonin plakun të merrte abdes mirë. Por, si do ta bënin këtë pa e prekur në sedër plakun dhe pa i shkaktuar plagë në shpirtin e tij? Plaku mund ta merrte këshillën e tyre si përçmim dhe me qëllim ai mund të ngulmonte në mënyrën e tij. Dy djemtë e vegjël menduan pak dhe erdhën te ideja që ta ndihmonin dhe ta udhëzonin plakun jodrejtëpërdrejt. Ata bënë sikur po grindeshin me njëri-tjetrin dhe secili prej tyre akuzonte tjetrin se nuk dinte si merrej mirë abdesi. Përfundimisht, ata vendosën të shkonin te plaku për ta zgjidhur grindjen. Iu afruan atij dhe i thanë: *"O babush! Ju lutemi, bëhuni arbitri ynë."* Plaku pranoi. Të dy djemtë filluan të merrnin abdes përpara tij dhe plaku i vështronte. Kur mbaruan, e pyetën plakun se cili e kishte marrë abdesin mirë. Plaku u përgjigj: *"Të dy e morët mirë, kurse plaku nuk e ka marrë mirë abdesin dhe e mësoi nga ju."*



Mësimi pesë

SI I PËRGJIGJENI THIRRJES SË ALLAHUT? (PJESA II)

Kryej namazin

Përse na ka urdhëruar Allahu të falemi?

Cila është vlera e faljes?

Cilët janë ata që e kryejnë realisht namazin?

Hyrje:

Deri tani folëm se si i përgjigjemi thirrjes së Allahut për t'u pastruar sepse Allahu i do ata që pendohen dhe pastrohen. Tani, të mësojmë se si t'i përgjigjemi thirrjes së dytë të Allahut, duke kryer detyrimin më të madh: faljen. Falja është mjeti për t'u lartësuar tek Allahu dhe është detyrim i çdo besimtari të përkushtuar. Le të njohim së pari arsyen përse Allahu na ka urdhëruar për t'u falur.



Përse Allahu na ka urdhëruar të falemi?

Ali bin Ebi Talib (Paqja e Allahut qoftë mbi të!), Prijësi i besimtarëve, thotë: *"Allahu i ka krijuar të gjitha krijesat e Tij, por Ai nuk ka nevojë për bindjen e tyre sepse as gjynahet e tyre, as bindja e tyre nuk ndikojnë tek Ai."* ³⁴ Allahu e di se ne na rrëmbejnë problemet dhe kënaqësitë e jetës dhe se mund të harrojmë veteveten. Kënaqësitë e jetës mund të na rrëmbejnë jetët tona dhe paratë tona. Dëfrimet dhe kotësitë mund të na shmangin nga qëllimi i krijimit tonë.

Kështu, mund ta harrojmë Krijuesin tonë dhe të humbasim. Ne mund të shijojmë vetëm gjërat lëndore të jetës dhe nuk arrijmë të kujtojmë kënaqësitë e adhurimit dhe të njohjes së Allahut.

I Gjithëfuqishmi nuk ka qëllim të na privojë nga kënaqësitë shpirtërore të jetës, por do që ne të shijojmë ëmbëlsinë e njohjes së Tij dhe të qenies afër Tij. Ai do të na çojë nga luginat e neglizhencës dhe nga fushat e lojës të shpëtimit, duke e përmendur Atë, duke e adhuruar Atë dhe duke u afruar tek Ai. Ai e di se ne kemi nevojë për një lidhje të fortë ndërmjet Atij dhe nesh. Ai e di se ne kemi nevojë për diçka që i qetëson shpirtrat tanë. Ai di se ne

³⁴. Bihar el Anuar (Detet e Dritës), vëll: 64, f. 342.



kemi nevojë për diçka që i pastron shpirtrat tanë dhe zemrat tona nga gjurmët e gjynaheve dhe të pakujdesisë. Prandaj, Ai na ka dhuruar një mjet të përhershëm, për ta mbajtur këtë lidhje të fortë - faljen (namazin). Allahu thotë: **"... Dhe kryejeni faljen rregullisht për të më kujtuar Mua!"** ³⁵

Kështu, qëllimi i faljes është ta kujtojmë Allahun, Bujarin që na ka krijuar ne, që na dërgon vazhdimisht mirësitë e Tij dhe që kujdeset vazhdimisht për ne dhe Ai e meriton ta përmendim Atë gjithnjë dhe ta mbajmë Atë gjithnjë në mendje. Ne kemi nevojë patjetër të falemi, kurse Ai nuk ka nevojë për faljen tonë. Mirësia që Ai na ka lejuar që ne të falemi për Të, është kaq e madhe. Imam Sexhadi thotë: *"Mirësia Jote më e rëndësishme është të të mbajmë në gjuhët tona duke të përmendur Ty."* ³⁶

Cila është vlera e faljes?

Në ajetin e mëparshëm falja konsiderohet kujtim i Allahut. Nëpërmjet faljes njeriu lidhet me Allahun. Falja është ndër veprat më të rëndësishme të njeriut. Ajo e bën njeriun ta kujtojë Allahun vazhdimisht. Ajo e forcon

³⁵. Ta Ha (Surja 20), ajeti 14.

³⁶. As - Sahifa Al - Sijadiah, f. 418.



lidhjen e njeriut me Allahun. Ajo e zgjon njeriun dhe e drejton për në rrugën e drejtë. Ajo nuk e lë njeriun të bjerë në rrugë të shtrembër. Ajo është një zgjim që e bën njeriun të mos zhytet në kënaqësitë e kësaj jete. Ajo i thotë njeriut se ka vetëm një Zot, se ka Xhenet dhe Xhehenem. Ajo i thotë njeriut se ai ka përgjegjësi e detyra më të rëndësishme të tjera para punës, gjumit, parasë e dëfrimit. Falja i kujton njeriut qëllimet e vërteta të ekzistencës së tij dhe kështu, ai nuk i harron këto qëllime, ndërkohë që ka edhe probleme të tjera. Falja na kujton Allahun; ne kujtojmë qëllimet tona; ne kujtojmë Jetën Tjetër.

Falja është zbatimi praktik i shtyllave të fesë. Ajo është zbatimi praktik i monoteizmit sepse është dëshmi praktike e njeriut për monoteizmin, sepse cilësohet vetëm Allahu, Ai që duhet adhuruar. Këtë e themi në vetë faljen, "**Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm nga Ti ndihmë kërkojmë**" dhe kur shqiptojmë dëshminë, "**Dëshmoj se nuk ka zot tjetër përveç Allahut**" dhe kur pohojmë profetësinë e profetit Muhamed: "**Dhe unë dëshmoj se Muhamedi është rob i Tij dhe i Dërguari i Tij.**" Kur vazhdojmë më tej faljen, siç na ka mësuar i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), ne zbatojmë besimin në Jetën Tjetër - Xhenetin dhe Xhehenemin. Prandaj ne falemi me gjithë zemër, duke pranuar "**Zotin e Ditës së Gjykimit**". Ja përse imam Bakiri ka thënë: "*Njeriu do të japë*



*llogari për faljen. Po të pranohet ajo, të gjitha të tjerat do të pranohen, gjithashtu."*³⁷

Cilët janë ata që e kryejnë realisht faljen?

Kjo është një pyetje që na imponohet. A konsiderohet ndër ata që falen ai që thotë *Allahu Ekber*, këndon ajetet e faljes, bie në ruku, bie në sexhde? A ka falja karakteristika të caktuara përpara Allahut? Besimtari im i nderuar! Përgjigjja juaj e parë mund të jetë mohuese. Atëherë, cilët janë ata që janë të ngulmët në falje? Përgjigjja është: Ata që e përmendin Allahun e Gjithëfuqishëm. Asnjë falje nuk e përmbush qëllimin e saj, në qoftë se bëhet pa kujdes dhe duke harruar Allahun. Për rrjedhojë, ajo nuk është falje. Allahu thotë: **"Mjerë ata, të cilët kur falen, janë të pakujdesshëm!"**³⁸ Allahu e cilëson pakujdesshmërinë e tyre si një të keqe të tmerrshme.

Ai thotë: **"O ju që keni besuar! Mos iu afroni namazit me mendje të mjegulluar, derisa ta kuptoni gjithçka që**

³⁷. Al Kafi, volume 3, f. 268.

³⁸. El Maun (Surja 107), ajetet 4, 5.



thoni!"³⁹ Ky është një paralajmërim për pakujdesinë tonë për çfarë themi dhe për çfarë bëjmë. Që të jetë falja ashtu siç duhet, sepse kur falemi jemi para Allahut e Allahu na sheh, ne duhet të jemi të përlurur dhe ta ndiejmë forcën e fjalëve dhe forcën e Atij të cilit i drejtohem: **"Ata që janë të përlurur në namazin e tyre."**⁴⁰

Fytyra e imam Aliut (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) **ndryshonte kur donte të pastrohej nga frika nga Allahu.**⁴¹ Kur vinte koha e faljes, ai dridhëronte dhe kur e pyesnin ç'ndodhte kështu me të, ai thoshte: **"Ka ardhur koha për besimin që iu ofrua qiejve dhe Tokës dhe qiejt dhe Toka nuk e pranuan sepse kishin të njëjtën frikë."**⁴² Nga ana tjetër, falja e vërtetë duhet të ndikojë në jetën e njeriut. Ai që falet duhet të jetë njeri i mirë e të sillet mirë sepse falja ka një qëllim aspirues - ta bëjë njeriun të mirë. Për këtë Allahu thotë: **"... Dhe fale namazin rregullisht sepse namazi të ruan nga shthurja dhe nga çdo vepër e shëmtuar..."**⁴³ Një njeri që vetëm betohet, nuk është ndër ata që falet. Ai që shkel të drejtat e njerëzve në pasurinë e tyre, në paranë e tyre, në nderin e tyre dhe në reputacionin

³⁹ . En Nisa (Surja 4), ajeti 43.

⁴⁰ . El Mu'minun (Surja 23), ajeti 2.

⁴¹ . Bihar el Anuar, volume 67, f. 400.

⁴² . Al - Haka' ik, f. 222.

⁴³ . El Ankebut (Surja 29), ajeti 45.



e tyre, nuk është njeri që falet. Prandaj i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: **"Ai, namazi i të cilit nuk e ndalon nga veprat e shëmtuara dhe të këqija, nuk është nga ata që falet."**

Si kryhet falja:

Pasi marrim abdes ose bëjmë gusul, qëndrojmë drejt përpara Kibles.

Themi *All'llahu Ekber* një herë, domethënë, *Takbirat el Ihram*.

Këndojmë suren *El Fatiha*.

Këndojmë ndonjë sure tjetër të vogël (p.sh., *El Ikhlas* etj.).

Themi *All'llahu Ekber* një herë, përkulemi duke vënë duart në gjunjë (rekati i parë) dhe themi: "*Subhane rabbijel adhiim ue bihamdih*".

Qëndrojmë përsëri në këmbë dhe themi *All'llahu Ekber* një herë dhe pastaj shkojmë në sexhde.

Bëjmë sexhden me katër pjesët e trupit, të cilat janë: balli, pëllëmbët e duarve, gjunjët dhe gishtat e mëdhenj të këmbëve. Pasi kemi vënë ballin në sexhde, themi: "*Subhane rabbijel a'la ue bihamdih*."



Themi *All'llahu Ekber* një herë dhe ngremë kokën e rrimë drejt; pastaj themi *All'llahu Ekber* një herë dhe bëjmë siç bëmë në sexhden e parë.

Ngrihemi për të kryer rekatin e dytë dhe veprimet siç vepruam në rekatin e parë, përveç Allahu Ekber të parë. Pasi kemi bërë sexhden e dytë, kur falim namazin e sabahut, themi: *"Esh'heduen la ilahe il'l all'llah Uahdehu la Sheriike leh ue esh'heduen'ne Muhammeden abduhu ue Resuluhu, All'llahumme sal'li ala Muhammed ue ali Muhammed"* (Unë dëshmoj se Allahu është i vetmi Zot, i Cili nuk ka shok dhe se Muhamedi është robi i tij dhe i Dërguari i Tij; paqja qoftë mbi Muhamedin dhe mbi pasardhësit e tij!). Pastaj themi: *"Es'selamu alejke ej'juhen nebij'ju ue rahmetull'llahi ue berekatuhu"* (Paqja, mëshira dhe mirësitë e Allahut qofshin mbi ty, o i Dërguari i Allahut! Paqja, mëshira dhe mirësitë e Allahut qofshin mbi ne dhe mbi adhuruesit e përkushtuar të Allahut! Paqja, mëshira dhe mirësitë e Allahut qofshin mbi ju!).

Kujdes:

1. Vendi ku bëhet sexhdja, duhet të jetë i pastër dhe nuk duhet të ketë copëra ushqimesh ose rroba e sende të tjera.
2. Mos fol, as mos lëviz gjatë faljes!



3. *All'illahu Ekber (Tekbirat el Ihram)* i parë duhet të thuhet një herë. Në qoftë se e thua atë përsëri, të dy bëhen të pavlefshëm.

4. Kur fal namaz, që ka tre rekatë dhe pas sexhdes së dytë të rukusë së dytë, thua vetëm pjesën e parë të Dëshmisë; pastaj ngrihesh për të vazhduar rekatët e mbetur. Ti mund të këndosh vetëm suren *El Fatiha* ose vetëm të thuash "**Subhanall'illah uel hamdulil'lah ue la ilahe il'lall'illah uall'illahu Ekber**" (I Lavdëruar qoftë Allahu dhe mirënjohja qoftë për Allahun dhe nuk ka zot tjetër përveç Allahut dhe Allahu është më i madhi) një herë ose tri herë. Kur mbaron rekatën që ka mbetur, thoni përsëri Dëshminë si më lart. Allahu i pranofte veprat tuaja dhe tonat!

Përmbledhje:

Meqë në jetën tonë kemi dëshira dhe kënaqësi, Allahu e di se ne kemi nevojë për një lidhje të fortë, që të mos e harrojmë Atë dhe që të kemi brenda vetes paqe dhe pastërti. Ja përse falja e forcon këtë lidhje me Allahun. Ajo është zbatim praktik për shtyllat e fesë.



Pyetje:

13. Përse na ka urdhëruar Allahu të falemi, megjithëse Ai nuk ka nevojë për këtë lloj adhurimi tonin?
14. Cilat janë ato veprime që ne duhet t'u kushtojmë vëmendje kur kryejmë namazin?
15. Thoni *i Vërtetë* ose *i Gabuar* në pohimet e mëposhtme:
 - a. Nuk duhet të rrimë në gjunjë pas sexhdes. ☐ ☐
 - b. Allahu nuk i pranon veprat e atyre që e trajtojnë namazin me mendjelehtësi. ☐ ☐
 - c. Falë mëshirës së Tij, Allahu i pranon të gjitha namazet e atyre që i kryejnë ato. ☐ ☐
 - ç. Namazi na jep forcë për të përballuar veprat e shëmtuara dhe të padrejta. ☐ ☐

LEXIM PLOTËSUES

Skllav apo njeri i lirë?

Muzika, këngët dhe vera po u çorodisnin kokat atyre që ishin brenda. Ndërkohë, një robinë haremi doli nga



shtëpia për të hedhur mbeturinat. Në rrugë ndeshi një burrë, që dukej si adhures.

Burri kaloi pranë dhe e pyeti atë: "A është pronari i kësaj shtëpie skllav apo njeri i lirë?"

"Njeri i lirë", u përgjigj ajo.

"Kështu është", - tha burri. "Po të mos kishte qenë njeri i lirë, ai do ta kishte frikë pronarin e tij."

Kur erdhi robina, pronari i saj e pyeti "Përse u vonove kaq shumë?" Ajo i tregoi atij çfarë kishte ndodhur me të dhe me njeriun në rrugë. Kur ajo mbaroi, pronari i saj meditoi për fjalinë e fundit, 'Po të mos kishte qenë njeri i lirë, ai do ta kishte frikë pronarin e tij', sepse ajo e goditi në zemër. Pastaj ai doli e vrapoi këmbëzbathur pas njeriut. Njeriu kishte qenë imam Musa ibn Xhafer (Paqja e Allahut qoftë mbi të!). I shprehu pendesën atij dhe që atëherë nuk mbathi gjë në këmbë derisa vdiq. Përpara asaj dite pronari i shtëpisë njihej me emrin Ebi Nasr Bishr ibn Harith ibn Abdul Rahman el Maruzi.

Pas kësaj dite ai u bë i njohur me emrin 'Bishr Këmbëzbathuri'. Bishri njihej për dashurinë e tij për argëtime e dëfrime pa mbarim; por, me siguri, fjala e imam Musa ibn Xhaferit ndikoi shumë tek ai dhe u bë arsyeja për pendimin e tij. Bishri u bë një adhures i ditur.



Mësimi gjashtë

SI I PËRGJIGJEMI THIRRJES SË ALLAHUT? (PJESA III)

(Ndiq fjalët e Allahut)

Përse na e ka zbritur Allahu Kur'anin e Shenjtë?

A është e mjaftueshme të kesh një kopje të Kur'anit të Shenjtë dhe të kërkosh të të bekojë ai?

Si do të përfitonte njeriu duke e lexuar dhe duke e dëgjuar Kur'anin e Shenjtë?

Përse na e ka zbritur Allahu Kur'anin e Shenjtë?

Siç u përmend në mësimin e mëparshëm, Allahu është Zoti dhe Sundimtari i njerëzimit. Është Ai që ia siguron njerëzimit nevojat materiale, si ushqimin dhe veshjen,



ashtu si edhe nevojat e tij shpirtërore, me qëllim që t'i bëjë njerëzit të afrohen me Të dhe të përfitojnë nga kjo afërsi. Pra, Allahu është Ushqyesi i trupave tanë, i shpirtrave tanë dhe i mendjeve tona. Allahu e ka ftuar njerëzimin ta njohë Atë. Por, meqë pamja fizike e Tij është e pamundur, Allahu ka zgjedhur të bisedojë me njerëzit për të larguar frikën dhe ankthin e tyre. Nëpërmjet kësaj Fjale, Allahu ia lehtëson frikën dhe ankthin njeriut nga njëra anë dhe nga ana tjetër, paraqit Vetveten te njeriu. Në këtë kontekst, Kur'ani është mjeti që ka parapëlqyer Allahu për ta përdorur për të biseduar me robtë e Tij, që ata të mund ta njohin Atë nëpërmjet fjalëve të Tij. Kur'ani është letërnjoftim (kartë indentiteti) për dijen dhe urtësinë e Allahut. Ai është një mesazh, tema e të cilit e njeh krijesat me Allahun e Gjithëfuqishëm.

Kur'ani është gostia e shpirtit dhe e mendjes. I Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: "*Ky Kur'an është gosti e Allahut. Prandaj mësoni nga gostia e Tij sa më shumë që të jetë e mundur!*" ⁴⁴ Kur'ani përshkruan kalimin nga errësira e injorancës në dritën e njohjes së Allahut, "**... Një Libër të cilin ta kemi shpallur ty (o Muhamed), për t'i nxjerrë njerëzit, me lejen e Zotit të tyre, nga errësira e thellë në dritë...**" ⁴⁵

⁴⁴ . Uasael Al Shiia, Volume 4, f. 826.

⁴⁵ . Ibrahim (Surja 14), ajeti 1.



Kur'ani është, gjithashtu, një recetë për shërimin e sëmundjes së shpirtit. Për këtë Kur'ani thotë: **"Ne shpallën nga Kur'ani atë që është shërim dhe mëshirë për besimtarët."**⁴⁶

Kur'ani është imazh që u përshtatet mendjeve tona dhe të kuptuarit tonë për Krijuesin, sepse njohja e urtësisë së Allahut është ndër urtësitë e Kur'anit, njohja e madhërisë së Allahut është ndër madhëritë e Kur'anit; duke njohur madhërinë e Kur'anit, ne mund të njohim lartësinë e Allahut; nga ëmbëlsia e Kur'anit, ne njohim mëshirën dhe dhembshurinë e Allahut.

A mjafton të kesh një kopje të Kur'anit të Shenjtë dhe të kërkosh të të bekojë ai?

Disa njerëz mbajnë kopje të Kur'anit për zbukurim. Ata mund t'i prarojnë ato me ar dhe mund të bëjnë mbajtëse për to. Ata mund t'i venë në vende të caktuara vetëm që më pas të fshijnë pluhurin mbi to. Ata mund t'i

⁴⁶. El Isra (Surja 17), ajeti 82.



mbajnë të tilla kopje vetëm sepse besojnë se Kur'ani do t'i mbrojë nga të këqijat dhe mëdyshjet. Sido që të jetë, ata rrallë e lexojnë Kur'anin. Natyrisht, të lutesh dhe të kërkosh të të bekojë e të të ruajë Kur'ani është gjë e mirë; por Kur'ani nuk ka zbritur kurrë për një qëllim të tillë. Po të ishte kështu, do të ishte shpërdorim i madh. Kushdo që e trajton Kur'anin në këtë mënyrë, është si një njeri që ka marrë një ftesë nga një mbret i madh e bujar për një ceremoni, me kusht që ky person të zbatojë kodet dhe kortezinë e sjelljes në këtë rast të madh. Kur bëhet një ftesë e tillë, tregohet se si mund të shkosh në një banket të tillë dhe se si të përfitosh nga një mundësi e tillë. Por, kur i ftuari e sheh bukurinë e ftesës dhe vulën e madhe të Mbretit të mbretërve, ai e puth atë dhe bën një kornizë për të dhe e mban në mes të shtëpisë, në mënyrë që kur t'i vijë ndonjë mik, ta shohë me krenari atë. Ai nuk e lexon asnjëherë atë, asnjëherë nuk u përgjigjet thirrjeve të saj dhe asnjëherë nuk i zbaton kortezitë e saj. Ai vetëm admiron dërguesin e saj dhe merret vetëm me zbukurimet e saj. Po ta lexonte atë, ai do të shqiptonte vetëm fjalët që përmban ajo, pa rrokur kuptimin e tyre. Nuk mund të ndodhë kështu me Kur'anin. Shqiptimi i Kur'anit është shqiptimi i fjalëve të Allahut. Ato janë drita e Allahut. Për këto arsye, leximi, shkrimi e dëgjimi i tyre janë të gjithë të dobishëm. Por ajo që kërkohet, është më shumë se vetëm t'i shikosh, t'i dëgjosh ose t'i lexosh. Qëllimet dhe bekimet e Kur'anit



janë shumë më të mëdha. Atëherë, eja t'i mësojmë dhe t'i kërkojmë këto të mira dhe këto bekime!

Si përfiton njeriu duke e lexuar dhe duke e dëgjuar Kur'anin e Shenjtë?

Kur'ani na drejton për tek e Vërteta, na njeh me Allahun, e forcon lidhjen tonë me Allahun dhe na çon në Rrugë të Drejtë. **"Vërtet, ky Kur'an udhëzon drejt asaj që është më e mira..."**⁴⁷

Në Kur'an gjejmë sqarime për rregullat e fesë, gjejmë hytbe dhe vaze, kode për jetën, përskrime për Jetën Tjetër, histori të popujve të mëparshëm, shkenca dhe kuptime që nuk janë vënë në zbatim ende etj. Kur jemi në errësirë, kërkojmë llambë për të gjetur rrugën. Atëherë, ajo që duhet, është të mendosh dhe të meditosh për ajetet e Kur'anit e t'i kuptosh ato, në mënyrë që të prekin dashurinë e madhe për Allahun dhe Xhenetin dhe ta ndihmojnë zemrën të lidhet shumë me Jetën Tjetër. Ajetet e Kur'anit janë shërim për shpirtin. Ai që nuk e lexon

⁴⁷. El Isra (Surja 17), ajeti 9.



Kur'anin, është si ai që ka shkuar te mjeku, ka marrë recetë nga mjeku, por nuk i ka marrë ilaçet. Atëherë, a mund të shërohet ai? E njëjta gjë thuhet edhe për ata që e vënë Kur'anin në një qoshe. Por Kur'ani është receta shëruese nga Allahu.

Përfundim:

I dashur vëlla! Mundohu të mësosh sa më shumë për Kur'anin sepse po veproje kështu, Kur'ani do të të hyjë në zemër dhe po të hyri në zemër, ai të rehaton. Pikërisht atëherë t'i ke ndërtuar një lidhje me qëllimet e tij të larta dhe ti nuk do të ecësh kurrë i vetëm. Imam Sexhadi (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) thotë: *"Edhe sikur të vdisnin të gjithë njerëzit në tokë, unë asnjëherë nuk do të ndihesha i vetëm, sepse me mua do të ishte Kur'ani."*⁴⁸

Ne dhe Kur'ani:

1. Kur'ani nuk duhet të çshenjtërohet dhe të poshtërohet.
2. Nuk duhet të preket Kur'ani, kur nuk je i pastër (domethënë, kur nuk ke marrë abdes ose kur nuk ke bërë gusul).

⁴⁸. Al Kafi, Volume 2, f. 602.



3. Nuk lejohet që një njeri, i cili ka pasur marrëdhënie seksuale dhe ende nuk ka bërë gusul, të lexojë më shumë se shtatë ajete.

4. Këshillohet shumë që ai që lexon Kur'an, të jetë i pastër (domethënë, të ketë marrë abdes ose të ketë bërë gusul).

Imam Ali ibn Ebi Talib (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) ka thënë: "*Ai që lexon*

Kur'an kur është i pastër, do të ketë njëzet e pesë të mira; kur është i papastër, dhjetë të mira." ⁴⁹

5. Pastro dhëmbët me misvak! I Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: "*Pastrohuni, ashtu siç ju thotë Kur'ani*"

Si të pastrohemi?

"*Gojën*", u përgjigj ai.

Me çfarë?

"*Me misvak.*" ⁵⁰

6. Drejtohu nga Kiblja në Mekë!

7. Fillo me "Eudhu bil'lahi mineshejtanir rraxhiim!" (Kërkoj mbrojtje nga Allahu prej shejtanit të mallkuar). **"Kur ti lexon Kur'an, kërko mbrojtjen e Allahut kundër shejtanit të mallkuar!"**⁵¹

⁴⁹. Uasailu Shia, Volume 4, f. 848.

⁵⁰. Al Mahasen Volume 2, f. 558.

⁵¹. En Nahl (Surja 16), ajeti 98.



8. Këndo ngadalë dhe përmirësoje zërin! I Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: "*Allahu asnjëherë nuk ka lejuar ndonjë gjë, siç ka lejuar këndimin e Kur'anit me zë të bukur.*" ⁵²

9. Këndo ose lexo, të paktën pesëdhjetë ajete në ditë me zë të lartë sepse shtëpitë ku këndohet ose lexohet Kur'an, janë shtëpi që ndriçohen për melekë! I Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: "*Ndriçojini shtëpitë tuaja me këndim Kur'ani.*" ⁵³

Përmbledhje:

Kur'ani i Shenjtë është mjeti me të cilin Allahu bisedon me robtë e Tij, në mënyrë që ata ta njohin Atë më shumë. Nga ana tjetër, Kur'ani është gosti për shpirtin dhe mendjen dhe rrugë që i drejton njerëzit nga errësira e padijes te drita e dijes. Prandaj, asnjëherë nuk është e mjaftueshme ta kesh Kur'anin dhe ta përdorësh atë për zbukurim: Kur'ani nuk ka zbritur kurrë për këtë qëllim. Ne duhet të bëjmë më shumë se vetëm ta shikojmë, ta dëgjojmë ose ta lexojmë atë. Qëllimet dhe mirësitë e

⁵². Al Mu'xhizat Al Nabauiah, f. 2.

⁵³. Al Kafi, Volume 2, f. 610.



Kur'anit janë më të rëndësishme se sa ta shikosh, ta dëgjosh ose ta lexosh atë.

Pyetje:

16. Cila është detyra jonë përpara Kur'anit të Shenjtë?
 17. Si përfitojmë ne nga Kur'ani i Shenjtë?
 18. Thoni *i Vërtetë* ose *i Gabuar* në pohimet e mëposhtme:
 - a. Shkenca më e rëndësishme e Kur'anit është intonacioni.
 - b. Vepra më e rëndësishme është ta kesh librin e Kur'anit dhe ta zbukurosh shumë atë. ☐ ☐
 - c. Që ta kuptosh Kur'anin, do të thotë ta lexosh a ta këndosh atë shumë. ☐ ☐
 - ç. Është e ndaluar ta mbash në duar Kur'anin pa abdes. ☐
- ☐



LEXIM PLOTËSUES

Asketizmi dhe përvuajtësia e imam Khomeinit

Sejjid Ekber el Husejni, përfaqësues i Teheranit në Këshillin Këshillimor të Shtetit (Parlament), thotë: *"Unë e kam njohur karakterin e madh të Ajetullah Khomeinit të madh. Unë kam parë tek ai një asket të vërtetë, që dëshiron Jetën Tjetër. Vetëpërmbytja dhe thjeshtësia sundojnë jetën e tij vetjake në atë shkallë, sa njerëzit nuk mund ta pranojnë atë a të pajtohen me të."*

Kurse Mosen Rafik Dosti, kryetar i Institutit të Veteranëve të Revolucionit Islamik thotë: *"Kur Shkëlqesia e Tij ishte President i Republikës, nuk kishte frigorifer në shtëpinë e tij. Prandaj, bleva një. Pas pak, frigoriferin e ulën poshtë. Por shkëlqesia e tij nuk ma tha këtë dhe frigoriferi mbeti i papërdorur gjatë gjithë kohës që ai qe President."* Më tej, ai thotë: *"Shtëpia e tij ishte me qilima të grisur. Një ditë, kur ai u largua, ne i mbështollëm ata dhe i shitëm. Pastaj unë shtova diçka nga paratë e mia dhe bleva qilima të rinj për shtëpinë e tij. Kur u kthye, ai tha: 'Çfarë është kjo Mosen?' I thashë se kishim hequr qilimat e*



*vjetër. 'Ke bërë gabim. Shko dhe merr qilimat e vjetër!' , - tha ai. Ne harxhuam shumë kohë për t'i gjetur qilimat e vjetër dhe për t'i sjellë prapë në shtëpi.'"*⁵⁴

⁵⁴. Marxhaijet Al Imam Al Kaid.



Mësimi shtatë

SI I PËRGJIGJEMI THIRRJES SË ALLAHUT (PJESA IV)

(I lutemi Allahut)

Përse lutemi?

A ka nevojë Allahu për lutjen tonë?

Kur është e dobishme lutja?

Hyrje:

Në mësimet e mëparshme folëm për pastrimin, faljen dhe këndimin a leximin e Kur'anit. Tani do të flasim për një mjet tjetër që na lidh me Allahun e Gjithëfuqishëm dhe për të kërkuar mbrojtje nga Allahu i Gjithëfuqishëm. Ky është mjet që nuk kushton fare sepse mund ta përdorim në çdo kohë dhe kudo ose kurdo që ne e ndiejmë se duhet dhe kur e ndiejmë se mund ta bëjmë atë. Ndryshe nga falja, nuk ka kufizim në kohë dhe nuk ka fjalë të caktuara



kur'anore për t'iu drejtuar Allahut. Sa herë që e ndiejmë dhe kurdo që e ndiejmë se zemra jonë dëshiron t'i drejtohet Allahut, ne, thjesht lejojmë gjuhën tonë t'i flasë Krijuesit tonë Bujar. Tani, të mësojmë çfarë është lutja (dua), nëse Allahu ka nevojë për lutjen tonë dhe kur është e dobishme lutja jonë.

Përse lutemi?

Ka një ndjenjë të thellë te çdonjëri nga ne: ne ndiejmë uri sepse kemi nevojë për ushqim; ne sëmuremi dhe kemi nevojë për një mjek dhe për ilaç; ndiejmë të ftohtë, të nxehtë, dhembje, frikë dhe ne kemi nevojë për zjarr, freskuese etj... Ne e ndiejmë se nuk dimë dhe kemi nevojë për mësues... Pra, qenia jonë shoqërohet me mungesa dhe me nevoja. Përse? Përgjigjia është: Allahu i Gjithëfuqishëm na ka krijuar që të jemi nevojtarë. Prandaj kemi motivin për t'iu drejtuar Atij dhe për t'i kërkuar Atij të na plotësojë mungesat dhe nevojat. **"O ju njerëz! Jeni ju që keni nevojë për Allahun, kurse Allahu nuk ka nevojë për asgjë dhe është i Denjë për çdo lavdërim."** ⁵⁵ Allahu nuk ka nevojë për asgjë. Jemi ne ata që kemi nevojë për dikë, që

⁵⁵. Fatir (Surja 35), ajeti 15.



të plotësojmë nevojat tona. **"Dhe Zoti juaj thotë: 'Lutmoni Mua! Unë do t'i përgjigjem lutjes suaj...'"** ⁵⁶ Allahu na fton t'i drejtohem Atij për çdo nevojë. Ai na i plotëson nevojat tona dhe Ai na siguron se do t'u përgjigjet lutjeve tona. Kush tjetër e mban fjalën më shumë se Allahu dhe kush betohet më shumë se Allahu! Askush tjetër. Në pjesën tjetër të ajetit Allahu, madje e konsideron mendjemadh këdo që nuk i drejtohet Atij: **"... Kurse ata që janë mendjemëdhenj e nuk duan të Më adhurojnë, do të hyjnë patjetër në Xhehenem - të poshtëruar."** Pra, dua ja është një shprehje e natyrshme e njeriut se ekziston Allahu dhe se Ai është burimi i pasurisë, i përsosurisë dhe i bujarisë.

A ka nevojë Allahu për lutjen tonë?

Në Kur'anin e Shenjtë, Allahu thotë: **"Thuaju (mohuesve): 'Zoti im nuk shqetësohet nga që ju nuk i drejtoheni Atij (me lutje).'"** Ky ajet është përgjigje për pyetjen: A ka nevojë Allahu për lutjen tonë? Allahu nuk ka

⁵⁶. El Ghafir (Surja 40), ajeti 60.



nevojë aspak. Ne kemi nevojë t'i afrohemi Allahut gjithnjë e më afër. Ne kemi nevojë për t'iu lutur Allahut, që ta ndiejmë ekzistencën e Tij. Ne kemi nevojë që t'i lutemi Allahut sepse kemi nevojë për të përmbushur nevojat tona. Duke iu lutur Allahut, ne e njohim Allahun. Duke iu lutur Allahut, ne e dimë se Ai është afër nesh dhe na shtohet lidhja me Të. Në këtë mënyrë, rezultati i duasë sonë do të jetë njohja e Allahut të Gjithëfuqishëm, njohja e veteve tona, përmbushja e nevojave tona, shijimi i ëmbëlsisë së qenies afër me Allahun dhe i bujarisë së Tij të pakufi. Kjo është arsyeja që Allahu thotë: **"Kur robtë e mi (besimtarë) të pyesin për Mua, (thua ju se) Unë jam afër, u përgjigjem lutjeve të tyre..."** ⁵⁷ Pra, Allahu është afër, Ai dëgjon, Ai e di nevojën tonë dhe e plotëson atë. **"Unë e dëgjoj lutjen e çdo lutësi, kur ai më drejtohet Mua..."** Ai përgjigjet.

Atëherë, përse do Allahu që ne t'i lutemi Atij, megjithëse Ai i di nevojat tona dhe nuk i duhet lutja jonë? Allahu përgjigjet: **"... Le ta dëgjojnë ata, gjithashtu, me dëshirë thirrjen Time.**" Përgjigjju thirrjes së Allahut duke iu lutur Atij, sepse kjo e shton besimin: **"... Dhe më besoni Mua: Që ata të mund të ecin në rrugën e drejtë."**

Duke u lutur, ne e njohim burimin e ekzistencës sonë - Allahun. Ne e njohim pasurinë e Tij dhe varfërinë tonë e nevojën tonë. Ne e mbështesim besimin tonë në bujarinë e

⁵⁷. El Bekare (Surja 2), ajeti 186.



Tij, në fuqinë e Tij dhe në mëshirën e Tij. Kjo është urtësia e Allahut, i Cili i njeh krijesat e Tij. Ai na lartëson për të arritur qëllim tonë; prandaj ne e kemi të domosdoshëm Allahun: **"Por, vërtet që njeriu i shkel të gjithë kufijtë, kur mendon se është i vetëmjaftueshëm."** ⁵⁸

Duaja (lutja) na lidh, gjithashtu, me Allahun, duke iu drejtuar Atij dhe duke e thelluar ndjenjën tonë për ekzistencën e Tij, bujarinë e Tij dhe mëshirën e Tij. I Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: *"Duaja është vepra më e mirë adhuruese."* ⁵⁹ Varfëria, nevojat, shqetësimet dhe dilemat që përjetojmë, tregojnë se sa të pafuqishëm dhe sa të dobët jemi ne për të përmbushur qëllimet tona.

Duaja na stërvit dhe na mëson të kontaktojmë me Allahun. Duaja na ndihmon t'i zbulojmë dhe t'i njohim më mirë shpirtrat tanë. Duaja na ndihmon ta njohim Allahun, Krijuesin tonë. Në këtë mënyrë, ne mund të lidhemi me Allahun. Në këtë mënyrë, ne mund ta përmbajmë tiraninë tonë dhe egërsinë tonë. Kur tregojmë pafuqishmërinë tonë dhe mëkatet tona, ne dëshirojmë që Allahu t'i shërojë shpirtrat tanë nga sëmundjet.

Duaja shton, gjithashtu, dashurinë për Allahun në zemrën e njeriut. Duaja shton ndjenjën tonë për bukurinë

⁵⁸ . El Alak (Surja 96), ajetet 6, 7.

⁵⁹ . Uasael Al Shia, Volume 4, f. 1088.



dhe bujarinë e Allahut. Imam Husejni (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) ka thënë: *"I Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: 'Duaja është arma e besimtarit, shtylla e fesë dhe drita e qiejve dhe e Tokës.'"*⁶⁰

Kur është e dobishme lutja (duaaja)?

Allahu thotë: **"Kërkoni prej Allahut nga mirësitë e Tij! Sepse Allahu ka dije të plotë për gjithçka."**⁶¹ Ka nevoja të caktuara, plotësimin e të cilave Allahu e ka kushtëzuar me duanë. Përveç kësaj, faza të caktuara shpirtërore nuk mund të arrihen vetëm se me duanë. Imam Sadiku (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) ka thënë: *"O Mejser! Bëj dua, por asnjëherë mos thuaj që diçka u bë! Allahu ka një radhë të caktuar, që nuk mund të arrihet, në qoftë se nuk lutesh. Në qoftë se robi e mbyll gojën dhe nuk kërkon asnjëherë asgjë, nuk do t'i jepet asgjë. Prandaj, Mejser, kërko që të të jepet! Nuk ka derë që nuk hapet, po u trokit në të."*⁶²

⁶⁰ . Al Kafi, Volume 2, f. 468.

⁶¹ . En Nisa (Surja 4), ajeti 32.

⁶² . Al Kafi, Volume 2, f. 466.



Përgjigjja për një lutje garantohet në qoftë se ajo (dua)ja bëhet për një nevojë reale. Dua ja duhet të jetë, gjithashtu, me interes për lutësin. Në qoftë se përgjigjja vonohet, robi ta dijë se Allahu zgjedh vetëm më të mirën dhe atë që është më me interes për lutësin. *"Mbase është mirë për mua për të mos pasur përgjigje tani për tani sepse ju e dini se si vijnë punët."*⁶³ Ne duhet të ngulmojmë në lutje dhe të bëjmë atë që duhet të bëjmë e jo të rrimë në shtëpi duke pritur që të ndodhin gjërat. *"Një lutës që nuk punon, është si një harkëtar pa hark."*⁶⁴

Ne duhet të kemi gjendjen e duhur për t'ia përkushtuar zemrën Allahut. Dua ja duhet të bëhet kur jemi të pastër. Dua ja duhet të bëhet me besim të plotë se Allahu, të Cilit i drejtohem, do t'i përgjigjet asaj. Imam Sadiku (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) ka thënë: *"Në qoftë se do të bësh lutje, duhet të besosh se pranimi i saj është te pragu i derës."*⁶⁵

Kur bëjmë lutje, duhet të punojmë shumë, të ngulmojmë të kërkojmë dhe të përkushtohemi: *"Lutjuni Zotit tuaj fshehtas dhe vazhdimisht!"* Një nga hadithet Kudsi thotë: *"O Isa! Lutmu Mua si një njeri që po mbytet ose si një njeri i dëshpëruar, që nuk ka askënd që ta ndihmojë! O Isa! Përulë zemrën tënde për Mua dhe më përmend shumë kur je vetëm! Dije se Unë do të kënaqem kur më lutesh Mua fshehtas! Ji*

⁶³. Tahzib Al Ahkam, Volume 3, f. 89.

⁶⁴. Nahxhul Al Balagha, Volume 4, f. 79.

⁶⁵. Al Kafi, Volume 2, f. 473.



i gjallë për këtë dhe jo i vdekur! Më lër të dëgjoj një zë të dëshpëruar!" ⁶⁶

Ne duhet të shfrytëzojmë kohën më të mirë për lutje, sidomos natën e xhuma. Imam Bakiri (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) ka thënë: *"Allahu thërret çdo natë të xhuma nga Froni i Tij, nga fillimi i natës deri në fund të saj...: A nuk ka ndonjë rob besimtar që pendohet përpara Meje për gjynahet e tij para agimit, që Unë t'ia shtoj dhënëtinë dhe shpërblimin? ... A nuk ka ndonjë besimtar të sëmure që më lutet Mua para agimit për ta shëruar, që Unë ta shëroj?... A nuk ka ndonjë besimtar rob që më lutet Mua për lirinë e tij, që ta çliroj?... A nuk ka ndonjë besimtar të shtypur që më lutet Mua për drejtësi përpara agimit, që Unë ta siguroj se drejtësia do t'i jepet atij? "*Imam Bakiri (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) ka thënë, gjithashtu: *"Allahu vazhdon të thërrasë në këtë mënyrë deri në mëngjes."* ⁶⁷

Përfundim:

Atëherë vëlla, le ta mbajmë hapur këtë derë të Allahut, sepse Ai u përgjigjet të gjitha lutjeve tona. Le ta mësojmë veten me lutje! Le ta mësojmë veten me kunutin (lutja që bëhet në mes të çdo faljeje)! Lutja që bëhet në mes të çdo

⁶⁶. Al Kafi, Volume 8, f. 138.

⁶⁷. Raudat Al Ua'aizin, f. 333.



faljeje është shumë e këshillueshme. Prandaj le të zgjedhim për veten tonë atë që thuhet në Kur'anin e Shenjtë dhe atë që thoshin pasardhësit e të Dërguarit të Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!). Le të gjejmë kohën për t'u lutur! Le të shkojmë në xhami çdo natë të xhuma për të marrë pjesë në duanë e Kumeilit, ta këndojmë atë dhe të meditojmë për kuptimet e saj! Le të shkojmë në xhami natën e mërkurë për të kënduar duanë "Tevasul" për t'iu lutur Allahut nëpërmjet Profetit dhe pasardhësve të tij (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), të cilët janë rrugë për tek Allahu! Le ta mësojmë veten të ballafaqohemi me ëndrra të këqija, të cilat sjellin zemërimin e Allahut! Le t'i çrrënjoshim mendimet e këqija!

Përmbledhje:

1. Ne jemi të varfër dhe nevojtarë. Allahu na ka krijuar të tillë, që t'i drejtohem Atij.
2. Lutja (dua) është mjet për ta njohur Allahun dhe për të forcuar lidhjen me Të.
3. Lutja është një shkollë, ku njeriu e ngre veten dhe e shton lidhjen e tij me Allahun.



Pyetje:

19. Si sigurohemi se marrim përgjigje për lutjen?
20. Përmendi një paragraf nga duaja e Kumeilit që ka të bëjë me varfërinë e njeriut dhe pasurinë e bujarinë e Allahut!
21. Thoni *i Vërtetë* ose *i Gabuar* në pohimet e mëposhtme:
 - a. Ai që nuk i lutet Allahut, është mendjemadh. ☐ ☐
 - b. Në qoftë se Allahu nuk i përgjigjet menjëherë lutjes së njeriut, do të thotë se ajo nuk është pranuar. ☐ ☐
 - c. Ne duhet t'i lutemi Allahut vetëm për gjëra kryesore dhe të rëndësishme. ☐ ☐
 - ç. Allahu i jep njeriut çfarëdo që të kërkojë pa bërë lutje. ☐ ☐



LEXIM PLOTËSUES

Bunkeri i Sejjid Abasit (Allahu e bekoftë shpirtin e tij!)

Avionët reaktivë të armikut po fluturonin shpesh mbi postën tonë. Truprojat e mi më sugjeruan menjëherë të fshihesha në disa shkurre, që aeroplanët izraelitë të mos më dallonin. Fill pas pak, komandanti i postës doli për të na kontrolluar. Pas një bisede të shkurtër, ai na dha urdhër të strehoheshim në bunkerin e afërt - bunkeri "Sejjid Abas". Unë u habita me këtë emër. Nuk kisha dyshim se Sejjid Abasi duhet të kishte qenë këtu gjatë jetës së tij së lavdishme të luftës. Ai duhet të kishte ardhur në frontin e rezistencës dhe duhet të kishte ndenjur midis muxhahedinëve e duhet të kishte shkëmbyer biseda me ta. Pa dyshim, ai duhet të jetë falur, të ketë ndenjur në atë bunker ose të ketë marrë pjesë në ndërtimin e bunkerit. Unë madje, edhe i thashë këto mundësi.

A ka ardhur këtu Sejjid Abasi dhe a ka marrë pjesë në ndërtimin e tij?

Jo.



Çfarë? Atëherë, ai duhet të jetë falur në të ose të ketë ndenjur me muxhahedinët në të.

Jo. Asnjëherë. Sejjid Abasi, martiri asnjëherë nuk pati ardhur në këtë pozicion.

Atëherë, si ka ndodhur që ai është quajtur bunkeri 'Sejjid Abas'?

Historia është kështu: një nga bashkëluftëtarët e rezistencës, që ishte pjesëtar i pozicionit, kaloi një herë një natë nga bunkeri. Dëgjoi një zë të dëshpëruar që vinte nga bunkeri. Ai e dinte se zëri ishte i Sejjid Abasit sepse e njihte mirë këtë zë. Por bashkëluftëtari nuk e imagjinonte kurrë që ta gjente Sejjid Abasin në bunker. Sejjid Abasi kishte rënë dëshmor shumë kohë më parë. Mirëpo, brenda s'kishte asnjë njeri. Atëherë, ai hyri në bunker. Në bunker s'kishte asnjë njeri, mirëpo zëri ishte. Bashkëluftëtari dëgjoi të njëjtin zë natën tjetër dhe ua tha këtë shokëve të tij. Atëherë, ata e quajtën bunkeri i Sejjid Abasit. Bunkeri që i vetmi vend ku Sejjid Abasi nuk e kishte parë kurrë në jetën e tij. Ndoshta ne mund të gjejmë një shpjegim për ardhjen e tij pas martirizimit të tij.⁶⁸

⁶⁸. Stories of the Free Men.



Mësimi tetë:

SI I PËRGJIGJEMI THIRRJES SË ALLAHUT? (PJESA V)

(Vizitoni Allahun në Shtëpinë e Tij)

Përse i ndërtojmë xhamitë?

Cili është roli i xhamive në jetën tonë?

Cila është e drejta e xhamive ndaj nesh?

Përse i ndërtojmë xhamitë?

Kur shkoni në vendet islame, ju tërheq një pamje shumë familjare, e cila është sinor i tyre - kubetë dhe minaretë që lartësohen drejt qiellit dhe përcjellin ezanin për t'u falur. Xhamitë janë si nënat që thërrasin fëmijët e tyre dhe ata vijnë si zogjtë te kllloçka. Ndërmjet xhamive dhe myslimanëve ka një lidhje të ndërtuar nga Allahu, kur Ai urdhëron që ata të falen në xhami dhe të ndërtojnë xhami. Allahu e ka thënë këtë në një ajet të Kur'anit të



Shenjtë: "... Drejtohuni vetëm nga Ai në çdo kohë dhe çdo vend faljeje dhe lutjuni Atij çiltërisht, me besim të pastër dhe të vërtetë..." ⁶⁹

Hadithe që nxisin ndërtimin e xhamive:

Transmetohet se Ebu Xhafer Sadiku (Paqja e Allahut goftë mbi të!) ka thënë: "*Kushdo që ndërton xhami, Allahu do t'i ndërtojë atij një shtëpi në Xhenet.*" ⁷⁰ Në jetën e tyre, njerëzit punojnë shumë dhe lodhen. Ata kanë nevojë të rifreskojnë fuqinë e tyre dhe ushqimin për të vazhduar jetën e tyre materiale. Si njerëz dhe si pasojë e punës sonë të vazhdueshme, ne kemi nevojë, gjithashtu, t'i mbushim shpirtat tanë me fuqinë e duhur dhe të mjaftueshme shpirtërore për qëndresën e kësaj jete shpirtërore, për ta vazhduar dhe për ta shtuar fuqishëm lidhjen tonë me Allahun, nga e cila ne marrim forcën, shpirtin dhe moralin. Ne e fitojmë moralin tonë nga xhamia sepse ne kemi nevojë ta takojmë dhe ta vizitojmë Allahun. Allahu e di këtë nevojë dhe Ai është Bujar. Ai dëshiron të hapë një shtëpi për të na pritur ne. Përcillet në një Hadith se në

⁶⁹ . El Araf (Surja 7), ajeti 29.

⁷⁰ . Al Mahaja Al Baida'a Volume 1, f. 356.



*Dhiatën e vjetër të Biblës shkruhet se shtëpitë e Mia në Tokë janë xhamitë. I bekuar është robi i cili pastrohet në shtëpinë Time. Por mikpritësi duhet t'i nderojë miqtë e tij, sidomos besimtarët që ecin me Mua në xhami në dritën verbuese të Ditës së Gjykimit."*⁷¹

Cili është roli i xhamisë në jetën tonë?

Xhamia është një nga burimet e moralit dhe të fuqisë shpirtërore. Ajo është vendi ku mbildhemi për të mbrojtur fenë tonë dhe kombin tonë. Imam Khomeini ka thënë: *"Xhamitë janë vendstrehimet tuaja, prandaj i mbushni plot vendstrehimet tuaja."* Në kohën e Profetit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), xhamia ishte Shtëpia e Allahut dhe burim i marrjes së moralit. Ajo ishte, gjithashtu, vendi ku qeveriseshin punët e popullit, ku përgatiteshin ushtritë për të mbrojtur Islamin dhe myslimanët, gjykatore për të gjykuar midis njerëzve, një vend ku myslimanët studionin problemet e tyre dhe një vend ku myslimanët takonin njëri-tjetrin. Xhamia ishte shkolla ku besimtarët mësonin rregullat e fesë nga imami i saj, pikërisht siç mësohej nga Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!). Në

⁷¹. Al Mahaja Al Baida'a Volume 1, f. 356.



xhami njeriu mund të njihet me besimtarët dhe të bëhet shok e vëlla me ta. Dhe më e rëndësishmja, xhamia është vendi ku ne falemi. Në xhami, Allahu adhurohet bashkërisht. Aty nuk dallohet i pasuri nga i varfri, pronari nga i punësuar. Meqë xhamia është vendi ku falemi me xhemat, ajo është faktori përbashkues për myslimanët.

Imam Ali ibn Ebi Talibi (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) ka folur për të mirat dhe përfitimet që kemi kur shkojmë në xhami: *"Kushdo që shkon në xhami, do të fitojë një nga tetë gjëra: një vëlla besimi, dije të dobishme, një ajet të përpiktë, një mëshirë të pritur, një fjalë që e largon njeriun nga padrejtësia, një fjalë që e çon njeriun në rrugën e drejtë, largim prej gjynahut nga frika dhe turpi."*⁷²

Cilat janë të drejtat e xhamisë ndaj nesh?

Xhamitë janë Shtëpitë e Allahut, Zotëruesit të të gjitha mirësive dhe bekimeve që gëzojmë dhe që na i ka dhënë pa ia kërkuar. Prandaj Allahu vendos si duhet të sillemi me xhamitë: **"Në xhami shkojnë dhe xhamitë i mirëmbajnë ata që besojnë tek Allahu dhe te Dita e Fundit."**⁷³ Allahu

⁷². Al Mahaja Al Baida'a, volume 1, f. 356.

⁷³. Et Teube, (Surja 9), ajeti 18.



do që ne të shkojmë në xhami dhe t'i mirëmbajmë xhamitë. Mirëmbajtja e trupit është t'i japësh ushqim; mirëmbajtja e shpirtit është të kryesh adhurimet. Po xhamitë si t'i mirëmbajmë? Po të meditojmë se xhamia është Shtëpia e Allahut, e të Madhit të më të Mëdhenjve, e Fuqisë së Qiejve dhe të Tokave, e Sunduesit dhe e Mbretit të Mbretërve, do të shohim që gjëja e parë që ne duhet të bëjmë për xhamitë, është ta madhërojmë Zotëruesin e tyre. Imam Sadiku (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) ka thënë: *"Po mbërrite te dera e xhamisë, ta dish se ke ardhur te një mbret i madh dhe aty mund të hyjnë dhe të ulen vetëm ata që janë të pastër dhe vetëm ata që janë të çiltër. Atëherë, ejani t'i shërbeni këtij Mbreti!"*⁷⁴

Xhamitë janë vendet ku adhurohet Allahu. Prandaj njeriu e ka detyrë ta ruajë shenjtërinë e tyre, duke i mbajtur ato të pastra, duke ulur zërin, duke përmendur vetëm Allahun, duke bërë adhurime të tilla, si namaz, lutje, duke bërë mësim etj. Ne nuk duhet t'ia kthejmë shpinën kurrë xhamisë. Imam Sadiku (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) thotë, gjithashtu: *"Tri gjëra ankohen tek Allahu: një xhami e braktisur, ku nuk falet askush; një dijetar midis njerëzve të paditur dhe një Kur'an i Shenjtë që është lënë në pluhur dhe askush nuk e lexon."*⁷⁵

⁷⁴. Misbah Al Sharia, f. 130.

⁷⁵. Favor of Jumaa and Jama'a, f. 10.



Njeriu këshillohet shumë të pastrohet në shtëpi dhe pastaj të vijë në xhami për t'u falur në vende të ndryshme. Imam Sadiku (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) thotë, gjithashtu: *"Faluni në vende të ndryshme të xhamisë, sepse çdo vend do të dëshmojë për faljen në Ditën e Gjykimit."*⁷⁶ Imam Sadiku (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) thotë, gjithashtu: *"Kushdo që shkon në xhami dhe shkel mbi sende të lagëta dhe të thata, do ta lavdërojë dheu deri në tokën e shtatë."*⁷⁷

Nuk është mirë që një fqinj i xhamisë të falet diku tjetër. I Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: *"Fqinji i xhamisë duhet të falet vetëm në xhami."*⁷⁸

Përmbyllje për faljen me xhemat

Allahu i Gjithëfuqishëm kërkon nga ne që ta bëjmë faljen të gjallë. Çdo gjë do bërë siç duhet. Të ndërtosh një karrige, do të thotë ta bësh atë të qëndrojë në këmbët e saj. Ta bësh një fëmijë të qëndrojë, do të thotë që ai të rrijë në

⁷⁶ . Favor of Jumaa and Jama'a, f. 9,

⁷⁷ . Favor of Jumaa and Jama'a, f. 9.

⁷⁸ . Favor of Jumaa and Jama'a, f. 9.



këmbët e veta. Kështu është edhe falja. Ne duhet të kujdesemi ta bëjmë faljen me nderim të madh, me çiltëri, me përkushtimin e zemrës dhe me përvëlje përpara Allahut. **"Kjo nuk është e lehtë për t'u arritur."** Atëherë, mënyra më e mirë për t'u falur dhe për t'u afruar tek Allahu është të bashkpunojmë për kryerjen e saj. Kjo bëhet nëpërmjet faljes me xhemat, sepse kur falemi bashkë, namazi do të na pranohet edhe sikur t'i pranohet një faltari të vetëm. Kur falemi me xhemat, shpërblimi dyfishohet. I Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) i ka thënë një herë Xhibrilit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!): *"Çfarë shpërblimi do të ketë bashkësia (ymeti) ime në faljen me xhemat?"* "O Muhamed! Po të jenë dy faltarë, Allahu do t'i shkruajë një qind e pesëdhjetë falje për çdo rekatë dhe po të jenë tre, Allahu do t'i shkruajë gjashtë qind falje për çdo rekatë." Më tej Xhibrili vazhdoi: *"Po të bëhen mbi dhjetë, shpërblimi nuk do t'i matet kurrë, edhe sikur detet dhe oqeanet të bëhen bojë, drurët e tokës, njerëzit, xhindet dhe melekët të bëhen shkruar. O Muhamed! Kur thuhet 'Allahu Ekber' me imamin, është më mirë se gjashtëdhjetë mijë haxhinj dhe se kjo jetë dhe çfarë ajo përmban për shtatëdhjetë mijë herë. Një rekat i falur me imam është më mirë se njëqind mijë dinarë që jepen për një të varfër dhe një sexhde e bërë me imam është më mirë se lirimi i njëqind skllëvërve."*⁷⁹ Falja më e mirë me xhemat është të bëhet pas një dijetari të fesë. Imam Sadiku (Paqja e Allahut qoftë mbi

⁷⁹. Favor of Jumaa Jumaa and Jama'a, f. 11 - 12.



të!) thotë: "*Falja me një dijetar fetar është e barabartë me një mijë rekatë.*" ⁸⁰

Përmbledhje:

1. Xhamitë janë sinorë për praninë e myslimanëve në një vend.
2. Xhamia është vendi ku myslimanët ripërtërijnë fuqitë e tyre shpirtërore.
3. Xhamia ka të drejtat e saj ndaj nesh dhe ne duhet t'i përmbushim këto të drejta.
4. Falja në xhami është falje me xhemat; ne bashkohemi për të na përfshirë Mëshira e Allahut.

Pyetje:

22. Cilat janë të drejtat e xhamisë ndaj nesh?
23. Cili është shpërblimi i faljes me xhemat?
24. Thoni *i Vërtetë* ose *i Gabuar* në pohimet e mëposhtme:
 - a. Xhamia është vendi ku myslimanët bashkohen për të qenë një dorë. ☐ ☐

⁸⁰. Favor of Jumaa and Jama'a, f. 12.



- b. Falja veças gjatë faljes me xhemat është e ndaluar. ☐ ☐
- c. Të falesh në shtëpi dhe ta lësh faljen me xhemat, e bën xhaminë të ankohet kundër nesh. ☐ ☐
- ç. Njeriu nuk mund të fitojë moral pa xhaminë. ☐ ☐

LEXIM PLOTËSUES

Shkujdesja në falje

Thuhet se Sejjida Zahra'a e pyeti një herë babanë e saj (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!): "O baba! Çfarë thua ti për burrat dhe gratë që janë të plogët kur falen?" Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) u përgjigj: "Oj Fatime! Ai që e fal namazin me plogështi, do të dënohet me pesëmbëdhjetë mënyra, gjashtë në këtë jetë, tri kur të vdesë, tri në varrin e tij dhe tri në Ditën e Gjykimit. Për dënimet në këtë jetë: Allahu do t'i heqë bekimin e moshës, të jetesës dhe të riskut dhe do ta lërë pa tiparet e njeriut të mirë në fytyrën e tij dhe çdo vepër që do ta bëjë, nuk do ta marrë shpërblimin për aq sa bën, lutja e tij nuk do të shkojë në qiell dhe nuk do ketë pjesë në lutjen për mirë. Për dënimet në vdekje: ai do të vdesë i poshtëruar; ai do të vdesë i uritur; ai do të vdesë i etur. Po t'i jepen lumenjtë e kësaj bote për të pirë, asnjë lumë nuk do t'ia



shuajë etjen. Për dënimet në varr: Allahu do t'i dërgojë atij një melek që e shqetëson atë, pastaj ia ngushton dhe ia errëson varrin. Për dënimet në Ditën e Gjykimit: Allahu do t'i dërgojë atij një melek, që do ta tërheqë zvarrë me fytyrë përmbys, kur të tjerët e shohin; pastaj do të gjykohet rreptë dhe në fund, Allahu nuk do t'ia hedhë sytë dhe nuk do ta caktojë për në Xhenet dhe do të vuajë dënimin më të rëndë." Al Mustadrak.



Mësimi nëntë:

RRUGA PËR TEK ALLAHU

(PJESA I)

Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)

Cila është rruga midis Allahut dhe krijesave të Tij?

Cila është rruga midis krijesave dhe Krijuesit?

Cila është pozita e të Dërguarve?

Cila është rruga midis Allahut dhe krijesave të Tij?

Kur lind fëmija, prindërit lumturohen. Ata e ushqejnë me qumësht me shumë kujdes dhe me dashuri. Ndërkohë që fëmija rritet dhe i dalin dhëmbët, lumturia e tyre shumëfishohet. Kur nis të belbëzojë, prindërit i flasin me dashuri dhe përpiqen t'i mësojnë fjalë të tilla, si mami dhe babi. Sigurisht, ata gëzohen pa masë, kur ai i shqipton për së pari këto fjalë. Ndërkohë, ata vazhdojnë të kujdesen derisa ai të bëhet i aftë të marrë përgjegjësitë e jetës dhe të



sillet mirë, që ai të mos shkojë në rrugë të gabuar në këtë det të madh të jetës.

Allahu i Gjithëfuqishëm kujdeset për njerëzit. Ai e ka bërë trupin e njeriut të tillë që të rritet. Ai i ka krijuar njerëzit ta njohin Atë. Allahu e ka pëlqyer shumë ta krijojë njeriun që ta udhëzojë dhe ta drejtojë për te Krijuesi i tij dhe të kujdeset për shpirtin e tij dhe fenë e tij, meqë Ai ka bërë të tjerë të kujdesen për të në jetën e tij. Allahu do që njerëzit ta njohin Atë dhe t'u flasë me dashuri, siç i flet me dashuri një nënë fëmijës së saj. Duhet të ketë një ndërmjetës te njerëzit, siç është gjuha e nënës, që i jep dashurinë fëmijës së saj. Në të njëjtën mënyrë u flet Allahu njerëzve: nëpërmjet të Dërguarve, të cilët janë të çiltër dhe besnikë kur ua përcjellin fjalët e Krijuesit krijesave të Tij. Meqë njerëzit janë njerëz, ata kanë nevojë për të tjerë t'u flasin atyre, që të mos ta ndiejnë veten si të huaj. Meqë njerëzit nuk kanë ndonjë mënyrë për t'u njohur me Allahun, Allahu u ka çuar të Dërguar nga gjiri i tyre për të përcjellë ajetet e Tij... Kur një ateist e pyeti imam Sadikun (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) përse dërgohen Profetë dhe të Dërguar, ai (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) u përgjigj: *"Pasi kemi provuar se kemi një Krijues të mbinatyrshëm, i Cili është më i Madhi sesa ne dhe gjithçka që Ai ka krijuar dhe se Ai është kaq i Lartësuar dhe ka Urtësinë më të Madhe, atëherë krijesat e Tij nuk mund t'i flasin Atij, madje as ta shohin ose ta prekin Atë. Prandaj, Ai ka dërguar ambasadorë te krijesat dhe*



*robtë e Tij, që t'i udhëzojnë për të mirën e tyre, për jetesën dhe për vdekjen e tyre."*⁸¹

I Dërguari është ambasadori i Allahut te krijesat e Tij, për t'i edukuar, për t'u kujdesur për to dhe për t'i njohur ato me Allahun e tyre e për të vepruar siç urdhëron Allahu, kështu që të ruhen të mos shkojnë në rrugë të gabuar. Prandaj, i Dërguari duhet të jetë besnik: ai duhet ta përcjellë mesazhin përsosurisht dhe ai duhet të tregojë se është i vërtetë në atë që thotë. Me fjalë të tjera, ai duhet të jetë i pagabueshëm dhe të mbështetet nga mrekullitë që bën.

Cila është rruga midis krijesave dhe Krijuesit?

Allahu thotë: "O Profet! Vërtet, Ne të kemi dërguar si dëshmitar, si sjellës të lajmeve të gëzuara e si paralajmërues dhe si njeri që fton për tek Allahu, me lejen e Tij dhe si një pishtar ndriçues."⁸² Me mirësinë e Tij, me mëshirën e Tij dhe me pozitën e Tij si Zot, Allahu e drejton njeriun tek Ai dhe e bën njeriun ta njohë Atë. Allahu ka çuar të Dërguarit e Tij dhe e ka përfunduar

⁸¹. Ilal Al Shara'ih, volume 1, f. 120.

⁸². El Ahzab (Surja 33), ajeti 46.



vargun e tyre me vulën e tyre, Muhamedin (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), që ai të ishte ai që do të ftonte për tek Allahu, me lejen e Tij. Ka një vend të madh, të ndërtuar nga Allahu, ku ka gosti të madhe për t'i nderuar njerëzit. Prandaj, Allahu u ka dërguar ftesa atyre me të Dërguarin e Tij për të marrë pjesë në këtë gosti. Bashkë me këtë të Dërguar, Allahu na çon një hartë për t'u treguar rrugën për të mbërritur në atë vend dhe i jep leje të Dërguarit të Tij të bisedojë me njerëzit për atë vend e për çfarë ka ai, për t'i bërë ata ta duan shumë Atë. Të Dërguarit e përshkruajnë atë vend. E përshkruajnë edhe rrugën se si mbërrihet deri aty dhe se çfarë do të ndodhte po të mos pranonin të bindeshin. Allahu thotë: **"O Profet! Vërtet, Ne të kemi dërguar si dëshmitar, si sjellës të lajmeve të gëzuara e si paralajmërues dhe si njeri që fton për tek Allahu, me lejen e Tij dhe si një pishtar ndriçues."**

I Dërguari qartëson mënyrën se si ta kesh nderin për të shkuar në rrugën e Allahut. Ai është një shembull për ata që e meritojnë këtë dhe i mbikëqyr njerëzit në përgatitjen e tyre për ta fituar atë Shtëpi.

I Dërguari është, gjithashtu, udhërrëfyesi i kësaj rruge dhe udhëheqësi i krijesave për te Krijuesi - **"si një pishtar ndriçues"**. Është ai që e ndriçon rrugën. Është ai që është shembulli në këtë rrugë. Ky i Dërguar është Muhamedi (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), i cili u çua nga Allahu për t'i mësuar dhe për t'i edukuar njerëzit, për



t'u qartësuar atyre besime, doktrina e ligje dhe për t'i udhëhequr ata te lumturia e vërtetë. Allahu thotë: "Është Ai që u solli analfabetëve një të Dërguar nga gjiri i tyre, për t'u lexuar atyre shpalljet e Tij, për t'i pastruar e për t'u mësuar Librin dhe Urtësinë, ndonëse ata më parë qenë, vërtet në humbje të plotë. " ⁸³

Cila është pozita e të Dërguarve?

Allahu është Zotëruesi i të gjitha të mirave dhe bekimeve të kësaj bote për ne. Ne duhet t'u përgjigjemi këtyre të mirave dhe bekimeve me një përgjigje pozitive dhe kurrë të mos i braktisim. Përderisa Allahu na ka çuar të Dërguar, ne duhet ta pranojmë Atë, ta pasojmë Atë, ta nderojmë Atë dhe ta duam Atë. Detyra jonë e parë ndaj të Dërguarve, sidomos ndaj Profetit Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) është të besojmë në profetësinë e tij dhe në atë që ai ka sjellë dhe t'u bindemi rregullave që na thotë, sepse duke ndjekur të Dërguarin, ne i përgjigjemi atij dhe Allahut që na e ka çuar atë. Në këtë mënyrë, jeta jonë bëhet e vërtetë. Allahu thotë: "O ju që keni besuar! Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit, kur ju

⁸³. El Xhumua (Surja 62), ajeti 2.



thërret drejt asaj që ju jep jetë!" ⁸⁴ Ai që nuk përgjigjet, domethënë, ai që nuk të respekton, nuk beson, nuk pajtohet me rregullat dhe rrugën e të Dërguarit është më shumë i vdekur sesa i gjallë. Ai është i verbër, i shurdhët dhe në dënim të përhershëm. Allahu thotë: **"Kushdo që i kthen shpinën Këshillës Sime, do të ketë jetë të mjeruar dhe Ne, në Ditën e Ringjalljes do ta ringjallim të verbër. Ai do të thotë: 'O Zoti im, përse më ringjalle të verbër, kur unë pata shikuar më parë?'"** Allahu do t'i thotë: **"Kështu të erdhën shenjat Tona dhe ti i harrove ato e prandaj sot do të jesh i harruar."** ⁸⁵ Ai, të cilit i janë dhënë sytë në këtë botë dhe që nuk eci asnjëherë në rrugën e drejtë, do jetë si një njeri që ka qenë i verbër gjithnjë. Allahu na ka dhënë atë që mund ta përdorim për ta dalluar të drejtën nga e shtrembra, të mirën nga e keqja dhe na ka dërguar dikë që të na drejtojë në këtë rrugë të drejtë. Po të largohemi nga Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) dhe nga Kur'ani i Shenjtë, do të jemi si i verbri dhe do të shkojmë në Ditën e Gjykimit të verbër (Allahu na ruajtë!).

⁸⁴. El Enfal (Surja 8), ajeti 24.

⁸⁵. Ta Ha (Surja 20), ajetet 124 - 126.



Përfundim:

I dashur vëlla! Mendo dhe medito: A i je përgjigjur thirrjes së Allahut? A e ke ndjekur Profetin Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)? A e ke përmendur Allahun apo e ke harruar dhe i ke kthyer shpinën? Ti duhet të përgjigjesh. Nëse nuk je përgjigjur deri tani, ti e ke ende një mundësi. Shfrytëzoje këtë mundësi dhe eja në gostinë e Allahut! Mos u largo nga përmendja e Allahut! Dije të drejtën e Allahut dhe të drejtën e Profetit Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ndaj teje!

Përmbledhje:

5. Allahu do që ne ta njohim Atë, ta përmendim me dashuri Atë dhe të ecim në rrugën e Tij.
6. I Dërguari dhe profetët janë më të mirët që mund të na flasin për Allahun.
7. I Dërguari dhe profetët janë drejtuesit, shembujt, udhërrëfyesit për në rrugën e drejtë.



Pyetje:

25. Cila është detyra e njerëzve ndaj të Dërguarve?
26. Cila është mënyra e komunikimit ndërmjet nesh dhe Allahut?
27. Thoni *i Vërtetë* ose *i Gabuar* në pohimet e mëposhtme:
 - a. Allahu do që njeriu ta njohë Atë sepse kështu gjen lumturinë. ☐ ☐
 - b. Ne nuk mund të afrohemi te Allahu pa ndihmën e të Dërguarve. ☐ ☐
 - c. Gjynahet e bëra nga Profeti janë gjynahe të vogla. ☐ ☐
 - ç. Allahu u ka dhënë mrekulli profetëve për t'i kontrolluar të tjerët dhe për t'iu bindur atij me forcë.

LEXIM PLOTËSUES

Njeriu që kërkonte këshillë

Një beduin nga shkretëtira erdhi te Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) në Medine për t'i dhënë ndonjë këshillë. Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) tha: "*Mos u zemro!*" Kur u kthye te fisi i tij,



thanë se disa djem kishin vjedhur pará në një fis tjetër. Fisi tjetër iu përgjigj duke bërë të njëjtën gjë. Ata dërguan disa djem të vidhnin fisin e beduinit. Tani, të dy fiset qenë rreshtuar për të filluar luftën. Kur ky beduini e mori vesh ndodhinë, po ziente nga zemërimi. Gjeti armë dhe u bashkua me fisin e tij.

Mirëpo më vonë, ai kujtoi çfarë i kishte thënë Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) për zemërimin, kur i pati kërkuar një këshillë. Beduini i thirri mendjes dhe mendoi me vete: "Përse zemërohem? Përse përgatitemi për luftë? Përse nxehemi pa arsye?" Pastaj ai iu drejtua udhëheqësve të fisit tjetër: "Ej njerëz! Për çfarë është ky konflikt? Në qoftë se ju keni ndonjë gjë që duhet t'jua japim, unë do t'jua jap nga paratë e mia. Nuk ka arsye për të luftuar dhe për të derdhur gjak." Kur udhëheqësit e fiseve i dëgjuan fjalët e tij, në shpirtrat e tyre erdhi mirësjellja dhe zemërgjerësia dhe thanë: "Ne kemi më shumë të drejtë të veprojmë kështu." Pastaj të dyja palët u pajtuan dhe asnjë luftë nuk u bë.



Përktheu: Liseda Ramaj

Mësimi dhjetë

RRUGA PËR TEK ALLAHU

(PJESA II)

Imami (Paqja e Allahut qoftë mbi të!)

- A janë bërë të parëndësishme rrugët për tek Allahu pas vdekjes së Profetit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)?
- Kush janë udhëzuesit pas Profetit Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)?
- Si i kemi ndërtuar lidhjet me Krijuesin tonë?



A janë bërë të parëndësishme rrugët për tek Allahu pas vdekjes së Profetit

(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)?

I Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka qënë miku i njerëzve gjatë gjithë jetës së tij. Ai e përfundoi misionin e tij duke përcjellë Mesazhin e Allahut, por mosha e tij (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ishte relativisht e shkurtër. Në atë kohë njerëzit ishin në fillimet e Islamit. Ishte e nevojshme që të ruhej Mesazhi i Profetit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), që të mos kishte shtrembërime të tij. Përndryshe, përpjekjet e Profetit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) do të shkonin kot.

Cila ishte garancia e Allahut për ta ruajtur mesazhin e Profetit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)? Në atë kohë, Profeti ishte edhe udhëheqës edhe udhëzues i njerëzimit drejt Allahut. A do të donte Allahu që njerëzimi të mbetej pa një udhëheqës që t'i udhëzonte? Kjo është arsyeja pse Allahu thotë: "O i Dërguar! Trego atë që të është shpallur nga Zoti yt! Në qoftë se nuk e bën këtë, atëherë nuk e ke përcjellë Mesazhin e Tij; Allahu të ruan ty prej



njerëzve..."⁸⁶

Prandaj, rruga drejt Allahut është e ruajtur nga Imami. Kështu edhe mesazhi arrin qëllimet e tij.

Në qoftë se nuk do të ishte Imami, Allahu nuk do të kishte asnjë justifikim për njerëzit. Nga Imami, brezat që vijnë përfitojnë nga përpjekjet e Profetit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!). Njerëzit kanë nevojë për një udhëzues, një udhëheqës, një mësues dhe një shembull. Sheriati ka nevojë për një person për t'i sqaruar, për t'i ruajtur dhe për t'i vënë në jetë vendimet e tij. Alibia e Allahut është e përfunduar me Imamin, prandaj feja është e plotësuar: "... Sot jua përsosa fenë tuaj, e plotësova dhuntinë Time ndaj jush dhe zgjodha që Islami të jetë feja juaj..."⁸⁷

Pra, kush do t'i dënojë ata që nuk besojnë? Kush do ta ruajë kombin nga devijimi në rrugën e gabuar? Është Imami ai që është përzgjedhur nga Allahu i Plotfuqishëm për të vazhduar misionin e thirrjes për tek Ai. Imami është prova e Allahut, prandaj ai duhet të jetë i sinqertë dhe i pagabueshëm. Për t'u siguruar se ky shoqërim shkon me të vërtetë drejt Allahut, njeriu ka nevojë për dikë që ta marrë për dore e ta udhëheqë drejt qëllimit, që është njohja e Allahut dhe afrimi me Të. Imami është rruga e drejtë që na çon të gjithëve tek përfundimi "**Ai na tregon rrugën e drejtë**".

⁸⁶ . El Maide (Surja 5), ajeti 67

⁸⁷ . El Maide (Surja 5), ajeti 3



Ashtu siç kishin nevojë njerëzit në kohën e të Dërguarit të Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) për një udhëzues, ashtu kishin dhe kanë nevojë për një imam në udhëtimin e tyre drejt Allahut pas Profetit. Ata kanë nevojë për një udhëheqës që të ecin në rrugë të drejtë dhe të mos devijojnë. " Të gjithë mbahuni fort për litarin e Allahut (Kur'anin) dhe mos u përçani! ..."⁸⁸

Nëse duhet të vendosim për të udhëtuar nga deti ose nga toka, ne nuk mund ta bëjmë këtë udhëtim me një udhëzues ose një kapiten që nuk e di rrugën. E njëjta gjë ndodh me udhëtimin tonë drejt Allahut. Ne kemi nevojë për një udhëzues që i di mirë rrugët e qiejve e të tokës dhe mënyrat për të arritur tek Allahu. Nëse ne do të arrijmë atje, do të ketë lumturi të plotë dhe të përjetshme. Islami ka sheriatin dhe ligjet për sistemin politik dhe shoqëror për të ndërtuar tokën, për t'i drejtuar njerëzit në rrugën e drejtë dhe për të përhapur drejtësinë. Por kush e kryeson këtë sistem? Kush e kontrollon zbatimin e legjislacionit dhe vendimet e tij? Kush është mëkëmbësi i Allahut dhe pasardhësi i Profetit në tokë?

⁸⁸ . Ali Imran (Surja 3), ajeti 103)



Kush janë udhëzuesit pas Profetit Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)?

Ne, vetëm dhe të pavarur, nuk mund ta përcaktojmë kush është udhëzuesi që duhet të ndjekim që të mos fundosemi. Ne nuk jemi në gjendje të bëjmë të njëjtën gjë me këta njerëz të cilët i janë nënshtruar Allahut. Allahu u dha atyre betimin e Tij. Allahu i di ata dhe i zgjedh ata.

I Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: *"Unë po ju lë ngarkim dy gjëra të rënda mes jush: Librin e Allahut dhe pasardhësit e mi të afërt. Ata kurrë nuk do të jenë larg, derisa ata të vijnë tek unë në basen."*⁸⁹ Dhe: *"Në qoftë se ju e mbani fort atë që unë jam duke e lënë në mes jush, ju kurrë nuk do të shkoni në humbje: Librin e Allahut dhe pasardhësit e mi të afërt."*⁹⁰

Ata njerëz, siç thotë edhe Profeti, janë si një anije shpëtimi nga tundimi dhe devijimi. Ai thotë: *"O bijtë e mi të afërt! Ju jeni si anija e Nuhut: Kushdo që hip në bord, do të mbijetojë dhe nuk do të përmbytet."*⁹¹

⁸⁹. Biharul Anuar, vëll. 5, f. 21.

⁹⁰ . El Irshad, vëll. 1, f. 176.

⁹¹ . Manakeb Amir Muminin, vëll. 2, f. 146.



Profeti përcaktoi edhe numrin, edhe origjinën e tyre: *"Populli im do të qëndrojë deri në dymbëdhjetë Kalifë, të cilët janë të gjithë prej Kurejshëve."*⁹²

Për më tepër, Profeti përcaktoi edhe emrat e tyre. Thuhet se një hebre i quajtur Noathol shkoi tek Profeti për t'i bërë atij disa pyetje. Ndër pyetjet e ngritura ishte rreth pasardhësve të tij dhe Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) i tha: *"Zëvendësi im është Ali Bin Ebu Talib, pasuar nga nipërit e mi Hasani dhe Hysejni dhe më pas, pasuar nga nëntë Imamë nga pasardhësit e tij. Pas Aliut, birit të Hysejnit, do të vijë Muhamedi, Xhaferi, Musai, Aliu, Muhamedi, Aliu, Hasani dhe së fundi Mehdiu, Imami i pritur. Këta janë dymbëdhjetë kalifët."*⁹³

Allahu i Plotfuqishëm e ka përcaktuar Imamin e parë në Kur'an: **"Miqte dhe mbrojtësit tuaj janë vetëm Allahu, i Dërguari i Tij dhe besimtarët që falin namazin dhe japin zeqatin, duke qenë të përlur (në adhurim) ndaj Allahut."**⁹⁴

⁹² . Biharul Anuar, vëll. 36, f. 231.

⁹³ . Janabi Mauada Lizauï Korba, vëll. 3, f. 281.

⁹⁴ . El Maide (Surja 5), ajeti 55



Si i ndërtojmë ne lidhjet me udhëheqësit e shenjtë?

Siç e thamë më lart, Profeti dhe pasardhësit e tij janë shumë të afërt me Allahun e Gjithëfuqishëm.

Ata janë porta që të çon tek Ai. "Prandaj, kushdo që dëshiron të vijë tek Allahu, do të duhet të kalojë nga dera që të çon tek Ai."⁹⁵ Pra, marrëdhënia me pasardhësit e Profetit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) është menduar të fillojë kur vetë Profeti ka besuar se ata janë vërtet të denjë për t'iu bindur. **"O besimtarë! Bindjuni Allahut, bindjuni të Dërguarit dhe atyre që drejtojnë punët tuaja..."**⁹⁶

Prandaj, bindja ndaj tyre është si bindja ndaj urdhrave të Allahut dhe ndaj udhëzimeve të Profetit të Tij. Ne jemi të urdhëruar t'i duam ata. " ...Thuaju: **"Për këtë nuk kërkoj kurrfarë shpërblimi tjetër prej jush, përveç respektit (për mua) për hir të fafëfisnisë (që kemi)..."**"⁹⁷

Prandaj, në qoftë se dikush e do dikë që e ka të afërm, atëherë edhe i afërmi do ta dojë atë. Të duash të dashurin e Allahut do të thotë ta duash Allahun. I Dërguari i Allahut është i dashuri i Allahut. Kështu, ta duash pasardhësin e

⁹⁵ . Duaja Nodba, Biharul Anuar, vëll. 99, f.107.

⁹⁶ . En Nisa (Surja 4), ajeti 59

⁹⁷ . Esh Shura(Surja 42), ajeti 23



Profetiti do të thotë ta duash Profetin dhe Allahun. T'i duash ata do të thotë t'i bindesh dhe t'i vizitosh ata; do të thotë të besosh në qëndrimet e tyre, sepse ata janë të ndershëm dhe të besueshëm. T'i duash ata do të thotë t'i mbështetësh dhe t'i ndihmosh ata të kryejnë misionet e tyre.

Përfundim:

Të nderuar! Përpiquni ta lavdëroni qëndrimin e këtyre njerëzve, të imitoni atë që ata bëjnë, t'i vizitoni ata, të përpiqeni që zemra juaj të jetë me ta, në mënyrë që të jetë me ta edhe në Jetën e Përtejme dhe për të marrë kënaqësinë e Allahut.

Përmbledhje:

1. Pas Profetit, njerëzit kanë nevojë për një shembull dhe një udhëzues për të vazhduar misionin e tij.
2. Imamët kanë një pozitë hyjnore. Ata janë të emëruar nga Allahu. Allahu urdhëroi Profetin për të treguar në lidhje me ta.



3. Ka dymbëdhjetë Imamë: Ali Bin Ebu Talib, Hasani, Hysejini dhe nëntë imamët, të cilët janë pasardhësit e Hysejinit. Imami i fundit është Mehdiu.
4. Ne duhet t'u bindemi Imamëve, t'i duam ata dhe t'i ndjekim ata.

Pyetje:

1. Kujt i drejtohet thënia e Allahut: "**Miqte dhe mbrojtësit tuaj janë vetëm Allahu, i Dërguari i Tij dhe besimtarët që falin namazin dhe japin zeqatin, duke qenë të përlur (në adhurim) ndaj Allahut.**"?
2. Kush është pasardhësi për të cilin flitet në ajet: "**O besimtarë! Bindjuni Allahut, bindjuni të Dërguarit dhe atyre që drejojnë punët tuaja...**"?
3. Shëno deklaratat e mëposhtme me *E vërtetë* ose *E gabuar*. Roli kryesor i Imamit pas Pejgamberit është që të vrasë ateistët.
- b. Prej mëshirës së Allahut mbi ne është edhe fakti se Ai na ka lënë të zgjedhim se kush duhet të jetë Imami.
- c. Një periudhë e caktuar kohore është ndërmjet Imamit dhe pasuesit të tij.
- d. Në porositë e Profetit ndaj myslimanëve, dy gjëra janë shumë të rëndësishme: Libri i Shenjtë dhe Syneti (tradita) e Profetit.



LEXIM PLOTËSUES

Turpi i njeriut në Ditën e Gjikimit

Dita e Gjikimit është dita kur të gjitha faktet dhe sekretet janë zbuluar. Pra, njeriu e kupton se Allahu ka qenë gjithmonë aty në të gjitha vendet, në kërkim të veprave të tij.

Njeriu do ta shohë veten më të shëmtuar se derri dhe majmuni. Ai do të shohë veprat e tij të shëmtuara, siç thotë Kur'ani: "(Kini frikë) ditën, kur çdokush do ta gjejë përpara atë që ka punuar mirë dhe atë që ka punuar keq, duke dëshiruar që midis tij dhe së keqes së tij, të ketë largësi të madhe..."⁹⁸

Për shkak të frikës dhe turpit, njeriu do të dëshironte që të shkonte menjëherë në Xhehenem për të shmangur turpin në atë ditë dhe para gjithë atyre njerëzve. Oh, çfarë çasti që e bën Xhehenemin një shëtitje të gëzueshme!

Siç është përcjellë, Imam Hasan el Muxhtaba ka nisur të qajë sa herë që është përmendur vdekja, varri dhe Ringjallja. Sa herë që është përmendur Xhehenemi dhe

⁹⁸ . Ali Imran (Surja 3), ajeti 30



Xheneti, ai është sëmurë. Sa herë që është përmendur qëndrimi para Allahut, ai ka rënë pa ndjenja.

Mësimi njëmbëdhjetë

RRUGËT PËR TEK ALLAHU

(PJESA III)

Jurisprudenca fetare

- Kush është udhëzuesi fetar pas Imam Mehdiut?
- Çfarë është *Taklidi* (E drejta e jurisprudentit fetar për të marrë vendime fetare)?
- Kujt do t'i drejtohem ne?

Hyrje

Në mësimet e mëparshme, ne kemi përmendur se feja ka nevojë për një kujdestar që ta mbrojë atë dhe Kur'anin, të kujdeset për çështjet e fesë dhe të



myslimanëve. Pas vdekjes së profetëve, Allahu ka caktuar Imamin për ta ndërmarrë këtë mision. Allahu për zgjodhi dymbëdhjetë Imamë, të cilët janë elita e njerëzimit dhe njerëzit më të mirë pas Profetit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!). Por pyetja që lind është: A do ta lërë Allahu këtë komb pa një udhërrëfyes pas Imam Mehdiut? A do ta lërë Allahu fenë pa dikë që e ruan dhe e shpjegon atë? A nuk kanë njerëzit nevojë për një person që t'u shpjegojë dhe t'u interpretojë ajetet e paqarta të Kur'anit?

Kujt do t'i drejtohet kombi në epokën e mungesës?

Nëse dikush ka për të udhëtuar për një kohë të gjatë apo të shkurtër, ai do të shkojë tek dikush që beson në të për të depozituar gjërat më të çmuara që ai ka. Imam Mehdiu e ka marrë Imamatin pas martirizimit të babait të tij Hasan Askariut me urdhër të Allahut. Ai nuk mund t'i kryente detyrat e tij në popull për shkak të kalifëve abasitë, të cilët donin ta vrisnin. Ata e dinin se ai ishte imami i dymbëdhjetë, i cili do ta mbushte tërë këtë botë me drejtësi, pasi të ishte zhytur në padrejtësi dhe tirani. Ata u përpoqën shumë ta largonin atë dritë hyjnore, por Fjalët e Allahut ishin thënë: "Ata dëshirojnë të fikin dritën e Allahut



me gojën e tyre, por Allahu e përsos dritën e Vet, edhe nëse (këtë gjë) e urrejnë jobesimtarët."⁹⁹

Allahu e shpëtoi Imamin nga abasitët dhe e fshehu atë për një periudhë kohore, e cila u quajt Mungesa e Vogël. Megjithatë, vendi kishte nevojë për të, kështu që ai emëroi disa nga bijtë e kombit për të mbajtur lidhje me popullin. Ata janë:

1. Osman Bin Said Amri
2. Muhamed Bin Osman Amri
3. Abu Kasem Hysejn Bin Ruh Nubakhti
4. Ali Bin Muhamed Samri

Megjithatë, Allahu ka vullnetin e Tij dhe ajo që do Ai, bëhet! Imami duhet të zhduket për një kohë të gjatë, derisa Allahu t'i japë atij leje të rishfaqet. Pra, a ka feja dhe njerëzimi nevojë për një mbrojtës, një mësues dhe një udhëheqës? A përfundon ndonjëherë kjo nevojë? Kurrë. Imami po udhëton për një periudhë kohe dhe ai duhet ta mbajë besimin e tij në duar të sigurt. Kush janë këta njerëz? Le të lexojmë midis rreshtave nga fjalët e Profetit dhe nga pasardhësit e tij që të mund të gjejmë përgjigje të plota. Duhet të lexojmë biografinë e Imam Mehdiut, që të shohim se Imam Mehdiu i ka emëruar personat, të cilëve kombi duhet t'u drejtohet, gjashtë ditë para se të vdiste pasardhësi i tij i katërt, Ali Bin Muhamed Samri. Me

⁹⁹ . Es Saff (Surja 61), ajeti 8



vdekjen e këtij të fundit, filloi dhe Boshllëku i madh. Por kujt do t'i drejtohet ky komb për të marrë vendime në punët e fesë dhe të jetës? Ndjekësit i ngritën këtë pyetje Imamit pasi vetë ata ishin të sigurt se dikush duhet ta luante këtë rol. Megjithatë, Profeti e ka caktuar tashmë se kujt do t'i drejtohet ky komb: Juristët fetarë janë të besuarit e profetëve.¹⁰⁰

Si mund të mos jenë ata të besuarit e kombit? Në fakt, përgjigjja e Imam Mehdiut erdhi kështu: *"Njerëzimi mund t'u drejtohet juristëve fetarë, të cilët luftuan kundër vetes së tyre, e ruajtën fenë e tyre, dhe iu bindën Allahut."*¹⁰¹ Vetëm atyre mund t'u drejtohem.

Çfarë është Taklidi

(E drejta e jurisprudentit fetar për të marrë vendime fetare)?

Në përgjigjen e mëparshme, dalluam shprehjen *"Njerëzimi mund t'u drejtohet juristëve fetarë në çështjet dhe në punët e tij"*. Çfarë është Taklidi atëherë?

Konteksti i mësipërm ilustron kuptimin e taklidit, që është: t'i drejtohesh udhëheqësit fetar në vendimet e fesë, ashtu sikurse Imami u drejtohet njerëzve të cilët kanë kualifikime shkencore, praktike dhe të sjelljes, në mënyrë që të na

¹⁰⁰. Mizan Hekma, vëll. 3, f. 2088.

¹⁰¹. Vesael Shia, vëll. 3, f.95, hadith 20.



udhëzojë nëpërmjet çështjeve të lejuara dhe ndaluara dhe që të dimë më shumë mbi doktrinat e Islamit. Përmes këtyre njerëzve, vazhdon komunikimi me vazhdimësinë e Imametit dhe të Imam Mehdiut.

Kur kemi një problem, ne duam të dimë arsyen. Kujt do t'i dretoheshim për të marrë një përgjigje? Kur kemi një problem në ndërtim, ne i drejtohemi një arkitekti. Kur kemi një problem shëndetësor, ne i drejtohemi një mjeku. Në qoftë se kemi një problem në çështjet tona të përditshme të adhurimit dhe që ka të bëjë me të tjerët, ne duhet t'i drejtohemi juristit fetar. Në këtë mënyrë, ne jemi duke i bërë ata përgjegjës për vendimin e dhënë.

Kujt do t'i drejtohemi ne?

Ashtu siç i drejtohemi një mjeku specialist me përvojë të mjaftueshme për t'ia besuar trupin tonë, ne duhet të bëjmë të njëjtën gjë me fenë tonë. Kjo është arsyeja pse një udhëzim i udhëheqësit fetar (Marxha Takleed) duhet të kenë shumë cilësi. Këtu dallojmë:

1. Ai duhet të jetë një jurisprudent, që di sesi të marrë vendime fetare nga Kur'anit dhe nga Syneti. Ai duhet të jetë i ditur, që të mund ta kuptojë Kur'anin dhe Synetin.
2. Ai duhet të jetë i besueshëm. Pra, ai duhet të jetë një besimtar që i bindet Allahut dhe që nuk bën gjynahe.
3. Ai duhet të kenë një kujtesë të shkëlqyer.



4. Ai nuk duhet të jetë i dhënë pas jetës, por duhet të jetë asketik.
5. Ai nuk duhet të jetë një dështak.
6. Ka shumë kushte të tjera.

Si i kuptojmë ne udhëzimet e udhëheqësit fetar (Merxha)?

Pasi kemi diskutuar cilësitë që duhet të zotërojë udhëheqësi fetar, ne kemi ende një dilemë, që është se si duhet bërë dallimi mes atyre që i kanë dhe atyre që nuk i kanë këto cilësi. Ka kushte të përcaktuara për këtë çështje me Sheriat:

1. Dëshmia e dy ekspertëve fetarë me përvojë.
2. Qarkullimi që është i dobishëm për njohuritë.
3. Kontrolli vetjak, i cili nuk mund të bëhet, veçse nga një ekspert fetar.

Për mësimin përmendsh:

Imam Aliu ka thënë: "Një dijetar fetar është si një palmë nga e cila ju prisni që të bjerë diçka."¹⁰² dhe "Mendja

¹⁰². Kaki, vëll. 1, f. 37.



që resht së dëgjuari intelektualët do të jetë e vdekur.”¹⁰³

Përmbledhje:

1. Imam Mehdiu ka caktuar ambasadorë që të jenë komunikimi i tij me njerëzit gjatë periudhës së mungesës.
2. Para vdekjes së ambasadorit të katërt, Imam Mehdiu i kërkoi kombit që t'i referoheshin vetëm juristëve fetarë.
3. Një urdhëresë e jurisprudentit fetar duhet të jetë domethënëse, e provuar dhe të ketë edhe cilësi të tjera. Sa për njohjen e një urdhërese fetare, ne mund të dimë një nga dëshmitë e dhëna nga dy ekspertë fetarë, nga kontrolli dhe nga qarkullimi, d.m.th. kur ai bëhet shumë i njohur për të gjithë.

Pyetje:

1. Çfarë është *Taklidi*?
2. Si mund ta dimë një urdhëresë fetare të jurisprudentit (*Merxhaa Al Takliid*)?
3. Shëno deklaratat e mëposhtme me E *vërtetë* ose E *gabuar*.

¹⁰³ . Mustedrek Vesael, vëll. 11, f. 207.



- a. Ne duhet t'i marrim vendimet drejtpërdrejt nga Pejgamberi (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) dhe nga Imamët (Paqja qoftë mbi ta).
- b. Një jurisprudent fetar është një dijetar fetar, i cili ka studiuar për një periudhë të gjatë kohore dhe ka lexuar shumë libra.
- c. Çdo urdhëresë fetare është një referencë e jurisprudentit fetar.
- d. Një jurisprudent fetar duhet të jetë një pasardhës i familjes së Profetit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), d.m.th. Hashimit.

LEXIM PLOTËSUES:

Disa dëshmi lidhur me njohjen e Imam Khameinit

"Unë vërtetoj se ai është më i dituri në mesin e kolegëve të tij bashkëkohorë. Allahu na bëftë me ju të përfitojnë nga njohuritë dhe udhëzimet. "

Ajetullah Sayed Jaafar Al Husseini Al Karimi

"Unë e di se asnjë prej atyre që janë emëruar të jenë udhëheqës fetarë nuk kanë qenë më të ditur se Imam Khameini."

Ajetullah Sheikh Ahmad Janati



"Unë besoj se Ajetullah Khameini (Allahu e mbroftë atë) është më i dituri dhe më i fuqishmi si për shkencat, për kushtet e tjera të nevojshme për takleed, ashtu edhe në udhëheqjen e vendit islamik."

Ajetullah Sheikh Mohamad Yazdi

"Duke ditur njohuritë e tij, mendimin e drejtë në të gjitha aspektet e ndryshme të Sheriatit islam dhe pikëpamjet e tij rreth individit dhe komunitetit, unë dëshmoj se ai është më i dituri dhe kështu, për mua, atë duhet ta marrim shembull".

Ajetullah Ali Sheikh Mohamad Al Taskhiri

"Unë besoj se Imam Khameini është më i miri dhe më i njohuri në shkencat e përgjithshme."

Ajetullah Sheikh Mohamad Ibrahim Janati



Mësimi dymbëdhjetë

RRUGËT PËR TEK ALLAHU

(PJESA IV)

Udhëheqësi

- Pse nuk kemi nevojë për një udhëheqës?
- Kush është udhëheqësi gjatë boshllëkut të madh?

Pse nuk kemi nevojë për një udhëheqës?

Imam Mehdiu u kujdes vetë për interpretimin e vendimeve fetare të rëndësishme për jetën e njerëzve. Ai ishte udhëheqës i njerëzve, të cilët iu drejtuan atij për çdo aspekt të jetës së tyre dhe për çështjet e fesë. Ai u përcaktoi rolet dhe funksionet e tyre në përputhje me ngjarjet dhe rrethanat në të gjitha fushat: politikë, ekonomi, sistem



ligjor etj. Si udhëheqës ai u shpjegoi vendime, të cilat duhej të zbatoheshin sa të ishte e mundur.

Ne duhet t'i shikojmë rregullat islame, që të kuptojmë se ata i mbulojnë të gjitha detajet e jetës njerëzore. Së pari, ata janë të rëndësishme për sjelljen e njeriut, për marrëdhënien e tij me Allahun, për të ndërtuar marrëdhëniet e njeriut me shpirtin e tij, ushqimin, veshmbathjen, punën, sytë, gjuhën dhe moralin. Së dyti, ata janë të rëndësishme për marrëdhëniet e njeriut me krijesat përreth tij, si kafshët, ujin, njerëzit, myslimanët dhe të tjerët. Nëse ne vëzhgojmë, gjejmë vendime të tilla, si:

1. Prerja e dorës së hajdutit
2. Gurëzimi i imoralëve
3. Rregullimi i çështjeve mes njerëzve
4. Mbrojtja dhe rregulli i Xhihadit
5. Rregullat për dhënien e lëmoshës, zekatit dhe të khumsit (1/5 e pasurisë dhe e fitimeve) etj.
6. Marrëdhëniet midis shteteve

Duke vëzhguar vendime të tilla dhe vendime të tjera të ngjashme me to, ne shohim se ata kanë nevojë për dikë që i zbaton në të njëjtën mënyrë. Përmbaruesit do të jenë institucionet dhe jo individët, sepse këto çështje janë punë dhe detyra të qeverive dhe shteteve.

Çështje të tilla të qeverisë mund të ekzekutohen nën udhëheqjen e një Profeti ose të një Imami të pagabueshëm. Po gjatë mungesës së Imamit, kush do t'i ekzekutojë vendime të tilla dhe kush do t'i mbikëqyrë ato?



Tek kush duhet të strehohemi?

Nëse i referohemi logjikës, kjo do të na çonte tek juristët fetarë, të cilët kanë shumë njohuri në rregullat e Islamit. Nëse pyesim Imamin, përgjigja do të jetë: "Sa i përket ngjarjeve që kanë ndodhur, ato i referohen atyre që thonë prapë fjalët tona. Ata janë dëshmia ime mbi ty dhe unë jam dëshmia e Allahut për ju."¹⁰⁴ Imam Mehdiu është ai që e emëron jurisprudentit fetar si një udhëheqës që ta pasojë atë. Udhëheqësi pas Imam Mehdiut është jurisprudenti fetar.

Përfundim:

Të nderuar! Sikur t'i mbyllnit sytë, t'i mbyllnit veshët dhe të thonit se nuk ka asnjë mënyrë për t'i ditur detyrat tuaja, ose sikur t'u bindeni urdhrave të udhëheqësit, i cili do të jetë një dëshmitar për ju, kush do ta kryente këtë funksion në favorin tuaj? Po sikur të mos kishit përputhje me mësimet e tij, kujt do t'i ankoheshit?

¹⁰⁴. Vesael Shia, vëll. 18, f. 101, hadithi 9.



Përmbledhje:

1. Udhëheqësi fetar është zëvendës i Imamit të pagabueshëm. Udhëheqësi fetar është udhëheqës gjatë mungesës së Imamit të pagabueshëm dhe është i caktuar nga ky i fundit.
2. Bindja ndaj udhëheqësit fetar është e domosdoshme si bindja ndaj Imamit, sepse duke iu bindur atij, urdhrat janë ekzekutuar, kufijtë janë mbajtur të sigurt dhe Sheriati ruhet.

Pyetje:

1. Kush e ruan fenë gjatë mungesës së Imam Mehdiut?
2. Tregoni hadithet përmes të cilave Imam Mehdiu emëron pasardhësit e tij.
3. Shëno deklaratat e mëposhtme me E *vërtetë* ose E *gabuar*.
 - a. Termi *Udhëheqës fetar* nënkupton një klerik, i cili ushtron përpjekje për të gjetur vendime nga Kur'ani dhe Syneti.
 - b. Bindja ndaj udhëheqësit fetar është t'i drejtohesh atij dhe ta imitosh atë.
 - c. Një njeri mund ta ndjekë fenë dhe të mos e ndjekë udhëheqësin fetar.



d. Në çdo vend duhet të ketë një udheheqës fetar, që Islami të jetë më i fortë.

LEXIM PLOTËSUES

Miku i Imam Aliut

Thuhet se një burrë bashkë me të birin, shkuan tek Imam Aliu. Ai i priti me zemërgjerësi dhe pastaj u ofroi ushqim. Ata hëngrën. Atëherë, shërbëtori i tij, Kanbari, solli pak ujë në një tas dhe e derdhi mbi duart e njeriut. Imam Aliu e mori ujin nga dora e shërbëtorit që t'ia hidhte vetë mbi duar mikut. Burri i tha: *"O Imam i dashur! A do të donit që Allahu t'ju shihte teksa ju jeni duke hedhur ujë mbi duart e mia?"* Imam Aliu u përgjigj: *"Lajini duart. Allahu të sheh, teksa vëllai yt, që nuk dallon prej teje po ju shërben dhe kështu rritet pozita e tij në qiell."*

Burri qëndroi drejtë për të larë duart e tij, por Imam Aliu i tha: *"Meqë ju e dinit se kush isha unë, lajini duart tuaja, sikur Kanbari është duke ju shërbyer juve."* Burri iu bind dhe kur ai përfundoi, Imami ia dha enën me ujë djalit të tij Muhamed Ibn Hanafia dhe i tha: *"O bir! Nëse djali do të vinte tek unë pa të atin, atëherë unë do t'i laja duart e tij, por Allahu nuk ka barazuar mes djalit dhe babait të tij, në qoftë se ata janë në të njëjtin vend. Babai ka hedhur ujë në duart e një babai,*



prandaj lëre djalin tani të hedhë ujë në duart e të birit." Muhamed Ibn Hanafia pastaj hodhi ujë në duart e djalit të zotërisë.

Imam Hasan Askariu e ka thënë këtë hadith dhe kur mbaroi, tha: *"Kushdo që e ndjek Aliun në të njëjtën mënyrë, është një shiit (ndjekës) i vërtetë."*



Pasqyra e lëndës

Mësimi një: Në kërkim të së vërtetës.....	7
Hyrje	7
A është jeta qëllim?.....	8
Cila është rruga e shpëtimit?.....	11
Përfundim.....	12
Përmbledhje.....	13
Pyetje.....	13
Lexim plotësues: Kurrë mos e përçmoni dhe mos e fyesi një besimtar.....	14
 Mësimi dy: A e njihni Allahun?.....	16
Rruga për ta njohur Allahun.....	17
Mendja të drejton tek Allahu.....	18
Shpirti na drejton për tek Allahu.....	20
Përmbledhje.....	23
Pyetje.....	23
Lexim plotësues: Histori miqësie.....	24
 Mësimi tre: Allahu na fton për tek Ai.....	26
Si na fton Allahu?.....	26
Përse na fton Allahu?.....	28
Për çfarë është ftesa?.....	30
Përfundim.....	33
Përmbledhje.....	33



Pyetje.....	34
Lexim plotësues: Sejjid Bahr Al Ulum provon të ndjerin Narakki.....	35

Mësimi katër: Si i përgjigjeni thirrjes së Allahut? (Pjesa I).....	37
Hyrje.....	37
Si i përgjigjeni thirrjes?.....	38
Përse pastrohemi?.....	39
Si pastrohemi?.....	41
Përfundim.....	42
Si të merrni abdes?.....	43
Kujdes.....	44
Përmbledhje.....	44
Pyetje.....	45
Lexim plotësues: Plaku dhe dy djemtë e vegjël.....	45

Mësimi pesë: Si i përgjigjeni thirrjes së Allahut? (Pjesa II).....	47
Hyrje.....	47
Përse Allahu na ka urdhëruar të falemi?.....	48
Cila është vlera e faljes?.....	49
Cilët janë ata që e kryejnë realisht faljen?.....	51
Si kryhet falja.....	53
Kujdes.....	54
Përmbledhje.....	55



Pyetje.....	56
Lexim plotësues: Skllav apo njeri i lirë?.....	56
 Mësimi gjashtë: Si i përgjigjemi thirrjes së Allahut?	
(Pjesa III).....	58
Përse na e ka zbritur Allahu Kur'anin e Shenjtë?.....	58
A mjafton të kesh një kopje të Kur'anit të Shenjtë dhe të kërkosh të të bekojë ai?.....	60
Si përfiton njeriu duke e lexuar dhe duke e dëgjuar Kur'anin e Shenjtë?	62
Përfundim.....	63
Ne dhe Kur'ani.....	63
Përmbledhje.....	65
Pyetje.....	66
Lexim plotësues: Asketizmi dhe përvuajtësia e imam Khomeinit	67
 Mësimi shtatë: Si i përgjigjemi thirrjes së Allahut? (Pjesa IV).....	
Hyrje.....	69
Përse lutemi?.....	70
A ka nevojë Allahu për lutjen tonë?.....	71
Kur është e dobishme lutja (dua)?.....	74
Përfundim.....	76
Pëmbledhje.....	77
Pyetje	78
Lexim plotësues: Bunkeri i Sejjid Abasit (Allahu e	



bekoftë shpirtin e tij!)	79
Mësimi tetë: Si i përgjigjemi thirrjes së Allahut? (Pjesa V)	81
Përse i ndërtojmë xhamitë?	81
Cili është roli i xhamisë në jetën tonë?	83
Cilat janë të drejtat e xhamisë ndaj nesh?	84
Përmbyllje për faljen me xhemat	86
Përmbledhje	88
Pyetje	88
Lexim plotësues: Shkujdesja në falje	89
Mësimi nëntë: Rruga për tek Allahu (Pjesa I)	90
Cila është rruga midis Allahut dhe krijesave të Tij?	90
Cila është rruga midis krijesave dhe Krijuesit?	92
Cila është pozita e të Dërguarve?	94
Përfundim	96
Përmbledhje	96
Pyetje	97
Lexim plotësues: Njeriu që kërkonte këshillë	97
Mësimi dhjetë: Rruga për tek Allahu (Pjesa II)	99
Imami (Paqja e Allahut qoftë mbi të!)	99
A janë bërë të parëndësishme rrugët për tek Allahu pas vdekjes së Profetit	100
Kush janë udhëzuesit pas Profetit Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)?	103



Si i ndërtojmë ne lidhjet me udhëheqësit e shenjtë?.....	105
Përfundim:.....	106
Përmbledhje:.....	106
Pyetje:.....	107
Lexim plotësues: Turpi i njeriut në Ditën e Gjykimit.....	108

Mësimi njëmbëdhjetë: Rrugët për tek Allahu (Pjesa III)..

Hyrje.....	109
Kujt do t'i drejtohet kombi në epokën e mungesës?.....	110
Çfarë është <i>Taklidi</i>	112
Kujt do t'i drejtohem ne?.....	113
Si i kuptojmë ne udhëzimet e udhëheqësit fetar (Merxha)?.....	114
Përmbledhje:.....	115
Pyetje:.....	115
Lexim plotësues: Disa dëshmi lidhur me njohjen e Imam Khameinit.....	116

Mësimi dymbëdhjetë: Rrugët për tek Allahu (Pjesa IV)...

Pse nuk kemi nevojë për një udhëheqës?.....	118
Tek kush duhet të strehohemi?.....	118
Përfundim:.....	120
Përmbledhje:.....	121
Pyetje:.....	121
Lexim plotësues: Miku i Imam Aliut.....	122



اسم الكتاب: بداية الطريق المستقيم

المؤلف: جمعية المعارف الإسلامية

تيرانا: ۲۰۱۵



نام کتاب: بداية الطريق المستقيم

نویسنده: جمعية المعارف الاسلامية

مترجم: بلدار شهو و ليسدا رامای

ویرایش: پروفیسور خیری شهو

زیر نظر: ولنت مریا

مقابله: ویولسا کارای

صفحه بندی و جلد: صبریه فرا

ناشر: جمعية النسيم

تیرانا: ۲۰۱۵